

Nuk mund të themi që kemi arritur diku,

Fjalorth
i termave të përbashkimit



por as nuk mund të themi që nuk kemi arritur diku

TABELA E PËRMBAJTJES

3	Hyrje
5	Të qenit i/e kuptuar
9	Bërja/Mbajtja/Dhënia e Hapësirës
13	Koha/Burimet
15	Përfshirja e komuniteteve
19	Mikpritja
23	Mënyrat e ballafaqimit me dallimet
27	Ndërthurja
29	Aleancat

33	Kundër përqendrimit vetëm te të rriturit
37	Parafytyrimi
39	Puna emocionale
41	Kundër diskriminimit të bazuar në aftësi të kufizuar (Anti-aftësisizmi)
45	Vetëfuqizimi
47	(Ç)mësimi
51	Lehtëso dhe de-eskalo
55	Shumica Globale
57	Rreth organizatave



Hyrje

A duhet që arti bashkëkohor të jetë ekskluziv? Përgjigja negative ndaj kësaj pyetjeje përbën bazën e kërkimit dhe eksplorimit tonë të përbashkët, të cilin e kemi emëruar Art Space Unlimited—një kooperativë e përkohshme e pesë hapësirave artistike evropiane, që kulmoi me këtë botim. Në një zotim të përbashkët për t'i ftuar dhe për t'u angazhuar me të tjerët, ishte e qartë që përpjekjet tona nuk duhet të kenë synim vetëm të angazhojnë publikun (dhe kundër-publikun, si për shembull: lëvizjet shoqërore, subkulturat ose njerëzit që përpiqen t'i sfidojnë normat mbizotëruese) por edhe të shërbejnë si një mundësi për të mësuar. Përgjatë procesit, u përfshim në diskutime dhe mësuam shumë, por çmësuam edhe më shumë. Kulmimi i kësaj energjie dhe i këtij eksplorimi përmbledhet në këtë botim, i cili përmban termat që na shërbyen si udhërrëfyesë dhe pika reference në këtë proces.

Këta terma u formësuan në një fjalorth—një përmbledhje e ideve, të cilat neve na u dukën fundamentale. Synojmë që ky libër të jetë i dobishëm për punonjësit/et kulturorë/e, ndërmjetësesit/et, kuratorët/et dhe artistët/et, si dhe për këdo që i bën vetes pyetje të ngjashme. Shpresojmë që termat, që po i prezantojmë këtu, do t'ua mundësojnë të tjerëve që të thellohen në çështjet që kanë të bëjnë me të ftuarit e audiencave të ndryshme përbrenda hapësirave të artit, duke ua mundësuar atyre që të arrijnë te përfundimet e veta, bazuar në kontekstet dhe situatat e tyre unike.

E kemi parasysh që shumë prej koncepteve me të cilat punojmë për kah natyra janë vazhdimisht të ndryshueshme dhe përkufizimi apo këndvështrimi ynë mund të sfidohet nga dikush tjetër në të ardhmen, mbase do të sfidohet edhe prej vetë nesh. Qëllimi i fjalorthit nuk ishte që ta gjejmë emëruesin më të ulët të përbashkët, por që të regjistrojmë diskrepancën e shpeshtë midis ideve dhe realitetit, duke identifikuar forma problematike të të menduarit, vepruarit dhe komunikuarit. Ishte detyrë e vështirë, pasi shumë prej çështjeve me të cilat u përballëm, nuk kishin përgjigje të qarta apo praktika të mira të themeluara. Në të njëjtën kohë, këta terma të fjalorthit iu përgjigjën pyetjeve, të cilat kishim nevojë vetë t'i shqyrtonim, në mënyrë që të kuptonim se çka funksionon për ne. Ne po ashtu besuam se ishte e nevojshme të ofrojmë kontekste dhe të

prezantojmë projekte, që e informojnë të kuptuarit tonë se çka do të thotë të jesh mikpritës, të krijosh aleanca dhe të navigosh konfliktin në sferën e artit bashkëkohor.


Në shumë mënyra, kjo nënkuptoi përkthim. Përkthim prej koncepteve shpesh të tejpërdorura dhe të mjegullta si gji-thëpërfshirja apo pjesëmarrja në terma, qasje dhe, në një kuptim më të gjerë, mënyrë të të menduarit që është kritike ndaj diskursit që ende mbizotëron në debatin kulturor në të ashtuquajturin Perëndim dhe Veri Global. Përkthimi i dijes së zhvilluar dhe praktikuar para nesh në ambiente dhe kontekste lokale. Në fund, përkthim i të arriturave tona të veçanta dhe konkrete, si dhe dështimeve tona në fjalë, me shpresën që ato mund të jenë burim për ata që kërkojnë udhëzim dhe këshillim në projektet dhe përpjekjet e tyre. Nuk është një përkthim që synon të jetë një rikrijim besnik i mendimit origjinal, por më shumë një përzgjedhje e kujdesshme. Secili nga termat në këtë botim paraqet një akt të përkthimit të përvojave dhe dijes së përfituar nga një organizatë gjatë pjesëmarrjes së tyre në Art Space Unlimited dhe përvojave tjera.

Libri është botuar përbrenda Art Space Unlimited, që është një projekt që buroi nga dëshira dhe përpjekja e përbashkët për t'i hapur institucionet për njerëzit, të cilët, për arsye të ndryshme, kanë qasje të vështirë, të ndërlikuar, të pamundësuar ose kufizuar ndaj artit, qoftë si krijues/e, pjesëmarrës/e apo shikues/e.

Projekti u krijua nga organizatat tranzit.cz (Pragë, Republikë Çeke, < rotor > (Graz, Austri), OFF-Biennale (Budapest, Hungari), La Escocesa (Barcelonë, Spanjë) dhe Fondacioni 17 (Prishtinë, Kosovë), për ta transformuar praktikën tonë institucionale, me qëllim që të jemi më empatikë/e, mirëkuptues/e dhe të hapur/a ndaj njerëzve me nevoja, përvoja dhe perceptime të llojllojshme. Ky libër është një përpjekje për ta lënë një gjurmë të ideve tona grupore, duke ofruar një gjuhë, metodologji dhe mjete të ndërvprimeve shoqërore, të cilat shpresojmë se do të jenë të dobishme për prodhimin empatik të ngjarjeve dhe projekteve kulturore.

Ne i trajtojmë këto çështje nga pikëpamja e punonjësve/eve dhe praktikuesve/eve të angazhuar/a dhe vetëkritikë/e, që kanë për qëllim të arrijnë te praktikuesit/et, të cilët/at punojnë në fusha të ngjashme. Edhe pse të informuar nga burime akademike, termat janë kryesisht të bazuar në përvojën tonë, të ndërtuar përmes praktikës. Detyra jonë nuk ishte që të imponojmë ngurtësi, por të njohim kompleksitetet e mendimit versus veprimet, të reflektojmë rreth pyetjeve të ndryshme që ngriten përgjatë punës sonë. Të ftojmë ty, lexues/e i/e dashur, që të angazhohesh me këta terma, t'i vësh në pikëpyetje, t'i përshtatësh dhe t'i transformosh përbrenda konteksteve tua.

Të qenit i/e kuptuar



Arti bashkëkohor—domethënë arti që pasqyron klimën aktuale kulturore, shoqërore dhe politike rreth botës dhe përfshin një varg të gjerë mediumesh—ka gjuhën dhe zhargonin e vet, si çdo fushë tjetër e aktivitetit njerëzor. Si në shumë disiplina tjera, gjuha eksperte në art ndihmon në kursimin e kohës për të gjithë palët e përfshira; gjërat nuk kanë nevojë të shpjegohen dhe kushdo që dëshiron të bëhet ekspert/e, duhet që fillimisht ta mësojë këtë gjuhë. Megjithatë, gjuha eksperte apo akademike e ka anën tjetër më pak të mirë. Nganjëherë është vetë legjitimimi i saj—një qëllim e jo një mjet.

Problemi me artin bashkëkohor është që, për të, shpesh flitet me një gjuhë eksperte, edhe kur duhet t'u flasë jo-ekspertëve/eve, gjë që ka një efekt tëhuajsues apo elitist. Në institucione publike siç janë muzetë, kemi departamente të tëra që punojnë në “përkthimin” e gjuhës eksperte të artit bashkëkohor (si p.sh., departamentet e ndërmjetësimit, zhvillimit të audiencës dhe edukimit). Është simptomë e kësaj situatë fakti që këto departamente janë shpesh më poshtë në hierarkinë e institucionit, në krahasim me programin artistik dhe kuratorial, në të cilin, shpesh nuk mund të ndërhyhet fare.

Për edicionin e vitit 2024 të Biennale Matter of Art, kuratorët/et dhe ne, në tranzit.cz, u pajtuam për një rregull të përbashkët: ta komunikojmë bienalen në gjuhë të përgjithshme, jo zhargon ekspertësh/esh. Bienalja zuri vend në Galerinë Kombëtare të Pragës, një institucion i madh në qendër të qytetit, i cili shpesh frekuentohet në verë jo vetëm nga vendorët, por edhe nga turistët që e duan kulturën. Nuk mund të pritet që turistët të kenë një gjuhë ekspertësh për artin, teksa po ashtu ata shpesh nuk kanë njohuri të mira të gjuhës çeke apo angleze. Prandaj, tekstet në anglisht, të shkruara nga kuratorët/et për punën e ekspozuar, u redaktuan me qëllim që të thjeshtohet gjuha. Një person që ka përvojë në mësimdhënie në anglisht dhe përkthim dhe që po ashtu është ekspert/e në art e kishte fjalën e fundit për përkthimet.

Tekstet duhet të ishin të kuptueshme për njerëzit me nivel mesatar të anglishtes dhe duhej që të mos kishin fjalë teknike, të cilave nevojitej t'ua kërkoje kuptimin. Tekstet, të redaktuara kështu, u pritën me rezistencë nga kuratorët/et dhe artistët/et. Një prej kuratorëve dhe disa prej artistëve u ndien që tekstet i thjeshtuan dhe rrafshuan idetë e shprehura nga veprat e artit, pavarësisht faktit që neve na dukej se nuk ua kishim ndërruar kuptimin teksteve. Në fund, tekstet për veprat e artit ishin kompromis, as krejtësisht të qasshme, as krejtësisht me gjuhë eksperte. Përfundimisht, ato pasqyruan tensionet me të cilat ishim përballur gjatë tërë kohës.

Në diskutime, ishte e qartë se për disa njerëz, "të qenit i/e kuptuar" nënkuptonte të mendosh në mënyrë më empatike rreth lexuesit apo pranuesit të tekstit. Për të tjerët, ishte më me rëndësi që tekstet të shprehnin idetë e tyre fjalë për fjalë, duke përdorur saktësisht termat e duhur. Një shembull është një artiste e quajtur Sráč Sam, me të cilën ne si tranzit bashkëpunojmë. Sam ka një besim *a priori* në artin e saj dhe në njerëz dhe ajo nuk dëshiron të ketë supozime rreth asaj se çka mund apo mund të mos kuptojnë njerëzit e as nuk dëshiron të bëjë përpjekje të vetëdijshe për t'u kuptuar. Megjithatë, në punën e saj *I Promise (Premtoj)*, ajo fton anëtarët e audiencës që të nënshkruajnë një dokument ku deklarojnë besimin e tyre në art në këmbim të një vepre të saj. Dëshira dhe qëllimi për t'u kuptuar mund të manifestohet në mënyra të ndryshme, edhe në vetë refuzimin e prerë për të bërë koncesione me qëllim që të tjerët të të kuptojnë ty.


Gjuha është e rrënjësuar në ndërtimin shoqëror; gjuha që e përdorim pasqyron statusin tonë sociokulturor dhe klasor. Gjuha e fushës së artit pasqyron statusin sociokulturor të njerëzve në të. Kur po diskutonim një prej librave tanë me

Laundry Collective, një kolektiv artistik, anëtarët/et e së cilit kanë përjetuar të qenit pa shtëpi dhe jetën në rrugë dhe kur e përmendëm termin “punëtor/e seksi”, ata qeshën. Na pyetën: E keni fjalën për “prostitutat”? Një herë e ftuam në kryeqytet një aktivist rom, një burrë nga klasa punëtore nga një qytet i vogël, në një ngjarje për ngritje fondesh për të mbështetur një nismë komunitare në të cilën ai ishte i përfshirë. Kryesisht të rinj të majtë erdhën në ngjarje dhe ishin të shokuar nga gjuha që përdorte ai. Për disa prej tyre, dukej se aktivisti rom përdorte gjuhën e politikanëve racistë.

Në qarqe aktiviste, akademike apo artistike, njerëzit janë shpeshherë shumë të kujdesshëm për gjuhën që e përdorin kur është fjala të ndjenjat dhe e drejta për vetëvendosje e njerëzve të cilëve u flasin. Ata/o janë të vëmendshëm ndaj dëmit që mund të shkaktohet me fjalë. Pozita prej së cilës flas është sigurisht një faktor në përdorimin e gjuhës. Është sigurisht ndryshe nëse unë, potencialisht, përdori një fjalë fyese për të përshkruar realitetin tim ose për të përshkruar një realitet, të cilin nuk e përjetoj. Megjithatë, komunikimi është proces dinamik. (Këq)kuptimi, mbi të gjitha, varet nga situata dhe kushtet në të cilat e gjejmë veten. Në disa situata të caktuara, kemi tendencë të mos duam të kuptohemi nga të tjerët—për shembull, në rrjete sociale ose, në përgjithësi, nën kushte që na duken armiqësore ndaj vetes sonë. Në situata tjera—për shembull, në një takim ballë për ballë ose në një kontekst që orientohet drejt të të kuptuarit—është më e mundur. A mund të mësojmë nga kjo në ngjarjet dhe programet që i organizojmë?

Në botën e artit, duhet të ketë një vend për “prostituata” dhe “punëtorë/e seksi”, një vend ku njerëzit mund të komunikojnë përtej klasës dhe dallimeve tjera. Më fjalë tjera, në art duhet të ketë vend për diskutime dhe tensione të ngjashme. Gjuha duhet të jetë e llojllojshme. Gjëja më e keqe është kur ekziston vetëm një gjuhë—ajo eksperte që krijon ndasi midis asaj që është brenda dhe jashtë. Është në rregull të mos kuptosh dhe të mos jesh i/e kuptuar, të gabosh ose të jesh i/e hutuar, por ky keqkuptim duhet të jetë një mjet, një shteg, jo një udhë pa krye. Është në rregull të mos kuptoni njëri-tjetrin, por kjo duhet të jetë pika kur ne kërkojmë për fjalë dhe gjuhë të reja, që na lidhin me të tjerët përkundër dallimeve.

Bërja/ Mbajtja/Dhënia e Hapësirës



Kultivimi i lidhjeve dhe besimit kërkon jo vetëm krijimin e hapësirave, por edhe bërjen, mbajtjen dhe dhënien e qëllimtë tyre. Këto janë veprime të ndërlidhura—bërja e hapësirës, mbajtja e hapësirës dhe dhënia e hapësirës—janë fundamentale në qasjen tonë. Kjo kornizë na ndihmon të nxisim gjithëpërfshirje, të inkurajojmë dialog dhe të sigurohemi që të gjithë e kanë mundësinë të kontribuojnë në mënyrë kuptimplotë. Duke i përkufizuar këto veprime, krijojmë një themel për angazhim më të thellë dhe rritje kolektive.

Bërja e hapësirës përfshin krijimin e mundësive për përvoja dhe mënyra të reja të të menduarit, duke dizajnuar një ambient ku kreativiteti mund të shpaloset lirshëm. Kur e hapëm Galerinë 17, kishim për qëllim të ofronim një platformë për eksperimentim artistik dhe angazhim shoqëror. Megjithatë, pa fondet e nevojshme për të renovuar hapësirën, ky vizion dukej i paarrtshëm. Jetësimi i vizionit u bë i mundur vetëm falë një fushate për ngritje fondesh—të mbështetur nga artistë/e, kuratorë/e, aktivistë/e dhe qytetarë, që besuan në fuqinë e artit dhe dialogut për të sjellur ndryshim shoqëror. Energjia dhe përkushtimi i tyre e shndërroi Galerinë 17 në një hapësirë për biseda që pasqyrojnë kompleksitetet e ambientit tonë të përbashkët shoqëror.

Pas kësaj, krijuam Rezidenca 17, një hapësirë për praktikë artistike, hulumtim, bashkëpunim dhe ekspozim, në Prishtinë, të strehuar në shtëpinë e Hivzi Sulejmanit—një ndërtesë publike e bashkëmenaxhuar me Komunën e Prishtinës—që ofron studio dhe hapësira të përbashkëta, të dizajnuara për angazhim ndërdisiplinar dhe të renovuar me mbështetje të drejtpërdrejtë nga komuniteti lokal.

Mbajtja e hapësirës është hap tjetër jetik në këtë proces. Kur një hapësirë bëhet, ajo duhet të mbahet. Kjo do të thotë të dëgjosh në mënyrë aktive, të jesh i/e pranishëm/me dhe të sigurohesh që të gjithë pjesëmarrësit/et të ndihen të dëgjuar/a, të mbështetur/a dhe të respektuar/a. Kërkon një përkushtim të thellë për të nxitur një atmosferë të besimit, sigurisë dhe hapjes. Në ekspozitën tonë “Queer Ecology”, mbajtja e hapësirës nënkuptoi krijimin e një ambienti ku artistët/et mund të punonin, eksperimentonin dhe ndërvepronin me publikun pa gjykim apo ndalesa. Dizajnuam hapësirën ashtu që mund të ishte aq e hapur, sa edhe intime, aq personale, sa edhe publike. Shërbeu si një hapësirë private e punës për artistët/et, duke u ofruar atyre lirinë që të zhvillojnë idetë, të eksplorojnë materialet dhe të angazhohen në reflektim kritik. Në të njëjtën kohë, hapësira mbeti e hapur për publikun në momente kyçe—përmes vizitave të organizuara dhe sesioneve ndërvepruese—duke u mundësuar audiencave të shohin dhe marrin pjesë në procesin kreativ.


Ky transformim i hapësirës inkurajoi një shkëmbim dinamik midis artistëve/eve, teoricienëve/eve, ekologjistëve/eve dhe anëtarëve të komunitetit, duke lidhur praktikën artistike me diskursin mjedisor dhe shoqëror. Duke kaluar prej formave personale dhe publike dhe anasjelltas, galeria u shndërrua në më shumë sesa vetëm një hapësirë ekspozuese; u bë një studio pune, një mjedis mësimi dhe një vend për angazhim kolektiv, ku bërja e artit u bë një akt i kërkimit të përbashkët. Dhënia e hapësirës ka të bëjë me shkuarjen një hap mbrapa, për të lejuar të tjerët të marrin hapësirën tërësisht, me zërat, rrëfimet dhe kreativitetin e tyre. Është një akt i hapjes së derës dhe lejimit të të tjerëve që të hynë brenda, duke krijuar një ambient ku të gjithë ndihen të fuqizuar për të kontribuar. Në Shtatëmbëdhjetë, një organizatë kulturore e bazuar në Prishtinë, dhënia e hapësirës do të thotë ofrimi i hapësirave dhe burimeve tona për përdorim afatgjatë dhe afatshkurtër. Qoftë nëse kemi të bëjmë me një ngjarje të vetme—një performancë, një bisedë publike ose një mbledhi—apo për angazhime më të gjata si për shembull: rezidenca artistike apo studio bashkëpunuese pune, ne ia hapim dyert kujtdo që ka diçka për të treguar. Në këtë mënyrë, jo vetëm që e ofrojmë hapësirën për krijim, por edhe për formim dhe rritje të lidhjeve.

Në Rezidenca 17, filozofia merr formë përmes ofrimeve fleksibile: artistët/et, aktivistët/et dhe anëtarët e komunitetit mund ta shfrytëzojnë hapësirën për nevoja afatshkurtra siç janë mbajtja e një ligjërata apo ekspozite, por ata po ashtu mund të marrin pjesë në rezidencat afatgjata, ku kanë mundësinë të angazhohen më thellësisht me punën e tyre dhe me njëri-tjetrin. Ngjashëm, në Galeria 17, hapësira u ofron artistëve

dhe kuratorëve lirinë për të krijuar, transformuar dhe përdorur hapësirën sipas vizioneve të tyre artistike dhe kuratoriale. Ky fleksibilitet, jo vetëm që e përmirëson procesin kreativ, por edhe e përfshin audiencën në një përvojë të përbashkët të komunikimit dhe rritjes.

Kështu, përmes bërjes së hapësirës, mbajtjes së hapësirës dhe dhënies së hapësirës, ne krijojmë ambiente, që janë fizikisht të sigurt dhe emocionalisht e intelektualisht pasuruese. Kjo qasje ndaj hapësirës shërben si themel për ndërtimin e besimit dhe lidhjeve të qëndrueshme midis artistëve/eve, humltuesve/eve, aktivistëve/eve dhe anëtarëve të komunitetit, të cilët angazhohen me punën tonë. Komuniteti ynë përfshin njerëz kreativë nga disiplinat e ndryshme, teoricienë/e, që eksplorojnë idetë e reja dhe qytetarët e investuar në ndryshim shoqëror dhe mjedisor—të gjithë duke u bërë bashkë për të nxitur dialog, bashkëpunim dhe mendim kritik.

Koha/ Burimet



Kur është fjala te përfshirja e njerëzve në proceset e krijimit artistik dhe punës kulturore, duhet të konsiderohet edhe pyetja në vijim: Kush ka kohë të marrë pjesë? Përgjigja në këtë pyetje lidhet me motivet e ndryshme që mund ta shtyjnë dikë që ta kontribuojë kohën (e lirë) e vlefshme në një projekt pjesëmarrës artistik ose që të marrë pjesë në një aktivitet edukativ. Shkëmbimi i dijes mund të jetë motiv, prapa të cilit qëndron kureshtja: Unë vij në një aktivitet të papaguar, në kohën time të lirë, me shpresë që do të kthehem në shtëpi më i pasur në përvojë dhe dije. Lidhjet miqësore mund të jenë qenësore: Unë shkoj në aktivitet sepse atje njoh njerëz me të cilët jam i lidhur dhe pres që të kaloj një kohë të këndshme. Një brengë e përbashkët mund të jetë vendimtare: Më duhet që absolutisht të marr pjesë në këtë aktivitet; është e rëndësishme për mua që ta mbështes këtë çështje përmes pjesëmarrjes sime. Dhe në fund, kompensimi financiar është motiv i fortë: Një pagesë e mirë ofrohet për pjesëmarrje në një nismë artistike, gjë që mund të kontribuojë në financat e mia.

Tema është përmendur sërish e sërish përgjatë praktikës sonë kulturore me pjesëmarrës individualë, e edhe me grupe të organizuara. Këta të fundit ndjekin logjikë tjetër. U bë me të vërtetë e qartë dhe e prekshme në kontekstin e një projekti me organizatën Danaida, një qendër edukative dhe pikëtakim për gratë në lagjen tonë. Shoqata ofron kurse gjermane dhe kurse të shkrim-leximit dhe atë që quhet “edukim bazik” për gratë migrante.

Kjo ndodhi disa kohë më parë, por ende ka ndikim. Në vitin 2012, qendra jonë e artit < rotor > propozoi një bashkëpunim me artisten që vepron në Graz, Maryam Mohammadi. Ajo tashmë kishte shumë përvojë në punën e kujdesshme me gra dhe veç kishte menduar për atë se çka mund të bënim bashkë me gratë nga kurset e Danaida. Megjithatë, kërkesa jonë miqësore u prit me një përgjigje të papritur: Na vjen keq, jemi shumë të zëna duke e mësuar përmbajtjen në kurset tona dhe nuk kemi kohë për të bashkëpunuar me një artiste.

Pasi e menduam mirë, pasi interesi bazik ishte aty, deshëm të kuptonim nëse do të kishte ndonjë mundësi për bashkëpunim. Zgjidhja ishte që ta integronim projektin artistik përbrenda planprogramit të kursit. Rezultoi në një projekt prekës “It’s in the hands of women” (është në duar të grave) si pjesë e kurseve. Në fund, 118 gra kontribuan në projekt duke sjellur me vete një objekt, që e kishin marrë me vete gjatë migrimit në Austri. Artistja i fotografoi objektet në duart e grave. Si pjesë e procesit të të mësuarit, gratë u ftuan të flisnin rreth kuptimit të objektit të tyre, historinë e vet personale dhe ta përshkruajnë në pak fjali. E tërë vepra më pas u ekspozua në një ekspozitë në Muzeun e Grazit, i cili më pas u vizitua nga shumë pjesëmarrës/e.

Që prej atëherë, grupet e Danaida me pjesëmarrëset e tyre gra, kanë qenë pjesë e “audiençës së rregullt” të < rotor >. Ne gjithnjë përpiqemi t’u përshtatemi nevojave dhe dijes ekzistuese të pjesëmarrëseve të kursit dhe të ofrojmë ndërmjetësim të përshtatur përkitazi me nevojat e caktuara. Kështu bëmë edhe me një punëtori përbrenda Art Space Unlimited, të mbajtur nga Nayari Castillo, anëtare e grupit Forest Encounters (Përvoja malore). Në punëtori, një grup i grave shkëmbyen pikëpamje të ndryshme rreth të të kuptuarit të tyre ndaj “malit”. Pjesëmarrëset shkruajtën përvojat e tyre personale të malit, qoftë në gjuhët e tyre amtare apo në gjermanisht dhe këto tekste u bënë pjesë e përmbledhjes Forest Encounters Glossary (Fjalorthi i Përvojave Malore).

Çka na tregon ky rrëfim, që filloi me një refuzim, rreth ekonomisë së kohës? Organizata jo-qeveritare me të cilën ishim të supozuar të punonim kishte një program të ngarkuar kursi dhe pjesëmarrësve supozohej t’u mësoheshin shkathtësi të caktuara. Nuk kishte kohë për tjetërçka. Dhe gratë që po i ndiqnin këto kurse i kishin angazhimet e tyre po ashtu. Shumë prej tyre ishin të zëna duke u kujdesur për fëmijët dhe duke i organizuar jetët e tyre të përditshme me një buxhet të vogël. Do të ishte e vështirë për to të gjenin kohë të punonin me një artiste, midis kurseve intensive që po i ndiqnin apo që të shfrytëzonin me iniciativën e vet atë që ofronte programi kulturor ose i ndërmjetësimit të një qendre të artit.

Në fund, ky grup i grave pati mundësinë të merrte pjesë vetëm për shkak të integritetit mjeshtëror të projektit të artit bashkëkohor përbrenda planprogramit të kursit.

Përfshirja e komuniteteve

Krijimi i hapësirave për komunikim dhe bashkëpunim nuk ka të bëjë vetëm me ofrimin e një platforme—ka të bëjë me të siguruarit që secili ndihet i dëgjuar, i vlerësuar dhe sikur është pjesë e diçkaje kuptimplotë. Ka të bëjë me të qenit të qëllimshëm në mënyrat se si angazhohemi me njerëz, duke u siguruar që ndërveprimet tona të jenë të sinqerta dhe jo thjesht sa për të kryer punë.

Në vend se të mbështetemi vetëm në ftesa formale ose lajmërimi publike, ne i japim përparësi angazhimit personal kur organizojmë ngjarje në Prishtinë apo tjetërkund. Kjo qasje mundëson që edhe zërat e atyre që shpesh lihen jashtë, të dëgjohen dhe të merren parasysh në formësimin e botës sonë. Duke i takuar njerëzit ku ata janë—qoftë në shtëpitë e tyre apo në vendet që i frekuentojnë, siç janë qendrat komunitare ose mbledhitë lokale—ne shkojmë përtej metodave digjitale për të ndërtuar lidhje më të thella dhe për të kuptuar njëmend nevojat e komunitetit. Kjo na bën që të krijojmë ngjarje më gjithëpërfshirëse dhe me ndikim.

Ky angazhim personal formëson punën tonë me hapësirat kyçe si Galeria 17 dhe Rezidenca 17. Prej fillimit, Galeria 17 ka qenë e përkushtuar të përfshijë komunitetin lokal. Në fakt, grupi i parë i ftuar në galeri ishin banorët e lagjes afër hapësirës në Prishtinë, të cilët patën mundësi të përjetojnë ekspozitën para se ajo të hapej për të tjerët. Që prej atëherë, çdo ekspozitë përcillet me një plan edukativ dhe të përfshirjes. Kjo përfshin kontaktet me shkollat, universitetet dhe organizatat e ndryshme jo-qeveritare dhe shoqatat, që punojnë në tema të ngjashme, për t'i ftuar që ta vizitojnë galerinë. Varësisht nga tema e çdo ekspozite, ne po ashtu ftojmë mesimdhënësit/et, ligjëruesit/et dhe studentët/et që të mbajnë klase, diskutime ose reflektime në galeri. Për më shumë, ne i dokumentojmë dhe arkivojmë ekspozitat në formatin 360 shkallë, duke ua mundësuar grupeve, që nuk mund të vijnë për vizitë fizikisht për arsye të ndryshme, që ta përjetojnë ekspozitën përmes realitetit virtual, VR.

Një prej momenteve më me ndikim i këtij angazhimi ndodhi kur ia prezantuam një ekspozitë VR një grupi nxënësish, të cilët kurrë s'e kishin përjetuar artin në mënyrë kaq të përfshirë. Shumë prej këtyre nxënësve vinin nga shkolla në Kosovë, ku ekspozimi ndaj teknologjisë ishte i kufizuar dhe mundësitë për përvoja të këtilla ishin të rralla, kryesisht për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe kushteve të vështira në shumë shkolla. Entuziazmi i tyre ishte ngjithës, me një nxënës, që tha “po më duket sikur po eci në Hapësirë!” Kjo përvojë tregoi fuqinë që teknologjitë e reja e kanë në bërjen e artit më të qashtëm, sidomos ndaj atyre që mund të mos kenë mundësinë të vizitojnë një galeri tradicionale, qoftë për shkak të vendndodhjes apo kufizimeve financiare.


Rezidenca 17 e ndjek një filozofi të ngjashme në zhvillimin e vet. Prej themelimit, kemi angazhuar grupe të ndryshme në restaurimin e kësaj hapësire të neglizhuar publike—shtëpia e dikurshme e Hivzi Sulejmanit, e cila tashmë është shtëpia e Rezidenca 17—në bashkëpunim me organizata jo-qeveritare, studentë/e të arkitekturës, artit dhe dizajnit nga universitetet publike dhe private në Prishtinë.

Takimet e rregullta dhe të vazhdueshme me komunitetin kanë qenë kritike në formësimin e programit dhe shërbimeve të programit përkitazi me nevojat lokale. Po ashtu, kemi përfshirë lagjen në dizajnimin e hapësirës së jashtme. Për ta rritur pjesëmarrjen dhe për t'u siguruar që ka pjesëmarrje diverse, personalisht kemi ftuar njerëz, duke ua shpjeguar misionin dhe duke i inkurajuar që të na bashkohen. Kjo qasje direkte ka çuar në pjesëmarrje më spotane dhe një numër më të gjerë zërash në bisedë. Po ashtu, shkojmë përtej lagjeve lokale. Një prej projekteve tona më të rëndësishme, Metamorfoza, përqendrohet në gjurmimin e historisë dhe kujtesës kolektive, që lidhet me ndërtesat e braktisura. Në kontekstin e Prishtinës, shumë prej këtyre ndërtesave lidhen me urbanizimin e shpejtë të qytetit dhe ngjarjet socio-politike, që e kanë formësuar Kosovën përgjatë dekadave të fundit. Pas luftës së të '90-ave të vona dhe tranzicioneve që erdhën pastaj, Prishtina—si shumë qytete tjera të dala nga konflikti—ka parë një përzierje të zhvillimit, neglizhimit dhe sfidave.


Ndërtesat e braktisura e reflektojnë këtë histori të vështirësive të mëdha dhe ndryshimeve të komuniteteve. Përmes këtij projekti, tërheqim vëmendjen kah rrëfimet mbrapa këtyre ndërtesave dhe e ftojmë komunitetin t'i ndajnë reflektimet e tyre. Kjo nismë përcillet nga botime dhe ekspozita, që dokumentojnë kontributet e komuniteteve lokale në ruajtjen dhe interpretimin e kujtesës së tyre kolektive. Përmes

Metamorfozës dhe ndërhyrjeve tjera në lokacione specifike, ne trokasim nëpër dyer, i ftojmë njerëzit të marrin pjesë në hulumtimin rreth kujtesës kolektive. Duke i angazhuar komunitetet në hulumtim, jo vetëm që krijojmë art, por edhe sigurohemi që përjetimet dhe rrëfimet e tyre të jenë pjesë e narrativës. Është e rëndësishme t'i përfshijmë njerëzit në bisedë dhe t'i bëjmë ata të ndihen sikur kanë hise në atë që po krijohet.

Përmes përfshirjes personale dhe bashkëpunimit, ne krijojmë ambiente ku komunikimi çon në bashkëpunim dhe bashkëpunimi çon në transformim. Kështu krijojmë ura midis ndasive—njerëzve, ideve dhe mundësive—dhe arrijmë ndikim të gjatë, kuptimplotë.



Mikpritja



Mikpritja e imagjinon dhe e bën të prekshëm një imazh të mundur të kësaj bote, gjë që për shumë njerëz po bëhet gjithnjë e më e rrallë dhe përvojat e të cilëve e përcaktojnë se çka marrim me vete dhe çka bartim te të tjerët. Mikpritja është një burim që pasurohet sa më shumë që e përdorim. Dhe, natyrisht, nuk ka të bëjë vetëm me mysafirin. Ata që mirëpresin mysafirët dhe ndajnë atë që është e tyre afirmojnë dhe fuqizojnë vetë përkatësinë dhe identitetin e vet. Përvoja e përbashkët e shkëmbimit mund të jetë rreth gjithçkaje që ka vlerë për ne, qofshin ato traditat, zakonet dhe pasionet, idetë apo planet, por edhe dështimet, frikat dhe përjetimet.

Në vitin 2020, OFF-Biennale u ftua nga kuratorët e documenta pesëmbëdhjetë, ruangrupa, për të marrë pjesë në komunitetin lumbung, që po formësonte programin e documenta. Lumbung, emri i të cilit vjen prej fjalës në indonezisht për hambar komunitar të orizit, ishte bërë metafora qendrore dhe *modus operandi* e këtij edicioni të documenta: një hapësirë e mikpritjes. ruangrupa ftoi komunitetet nga e gjithë bota që të bashkëpunojnë—duke kundërshtuar kësisoji hegjemoninë perëndimore—dhe kërkoi nga ta që t'i tregojnë agjendat e veta, përkushtimet dhe përvojat se si ata funksionojnë me njëri-tjetrin dhe me audiencën e documenta, si dhe që të krijojnë një mënyrë radikalisht ndryshe ekonomike dhe bashkëpunuese të funksionimit për edicionin e pesëmbëdhjetë të kësaj ngjarjeje prestigjioze në botën perëndimore të artit. Miqësia u bë baza për bashkëpunim dhe ishte baza e këtyre planifikimeve ekonomike që ridizajnuan kornizën institucionale të documenta. Ftesat sillnin më shumë ftesa: Komunitetet e përfshira nga ruangrupa patën mundësinë që të ftojnë të tjerët, duke shpërbërë kështu themelet e funksionimit të centralizuar.

Në këtë mënyrë, OFF-Biennale Budapest pati mundësinë që të jetë nikoqire e një varg artistësh dhe nismash artistike, duke rishpërndarë dhe shumëzuar burimet që u ofrohen atyre. Sfida e parë në këtë mënyrë radikalisht të re të funksionuarit, që e sfidoi konceptin e mikpritjes, ishte pandemia Covid-19, që ndaloi takimet fizike dhe mundësinë që të njohim njëri-tjetrin në hapësira të përbashkëta, si dhe inicoi forma më

të kufizuara të mikpritjes. Në biseda të Zoom, nganjëherë të ndjekura nga qindra njerëz, ne krijuam miqësi në mënyra që s'i kishim provuar më parë: takoheshim online, luanim lojëra, muzikë dhe organizonim ndeja për ta lehtësuar hidhërimin, e edhe frikën, teksa provonim të formësonim kornizën për edicionin e radhës documenta dhe themelet e një komuniteti që mund të rrinte bashkë edhe më vonë.

Ishte e vërejtshme që, derisa për disa, mikpritja është një gjest më i rrënjosur kulturalisht dhe që karakterizon jetën e përditshme, për të tjerët është proces i të mësuarit, me të cilin angazhohen në mënyra të ndryshme.

Ky proces i të mësuarit kërkon më pak edukim formal dhe më shumë përvojë. Ata që priten—dhe këssoji përjetojnë forma të ndryshme të të qenit të mirëpritur dhe pranuar—bëhen më të hapur kur është fjala te bartja tutje e këtyre përvojave. Kur hyjmë në ambientin e dikujt—"shtëpinë" e tyre—ne mirëpritemi jo vetëm prej njerëzve, po prej gjithë mjedisit. Përmes njohjes dhe të të kuptuarit të dallimeve kulturore, përvoja shumë-shtresore e të qenit në atë ambient na ndihmon t'i kuptojmë pikat e lidhjes. Kishim mundësi të kufizuara për ta bërë këtë, pasi përvoja shqisore, spontaniteti dhe gjestet jo-verbale na vinin përmes një mediumi pengues (distanca, meditim, koha dhe pasiguria e shkaktuar nga Covid) duke e zbehur fuqinë e mesazheve.

Udhëtuam brenda kokave tona, përballë ekraneve dhe pas shumë muajsh, me heqjen e ngadaltë të masave kufizuese, kur mund të takoheshim në grupe të vogla për herë të parë në Kassel, i kërkonim fytyrat e njohura mbrapa maskave. Edhe me fundin e pandemisë, kishte mjaftueshëm sfida; mikpritja u përball me muret e larta të mbajtjes së status quo të ekspozitave të mëdha të artit. documenta nuk mund ta kapërcente hijen e vet dhe shumë prej atyre që erdhën në vizitë, u kthyen të hidhëruar, edhe më herët se ç'e kishin planifikuar.

Megjithatë, kjo gjë po ashtu na mundësoi që t'i përjetojmë gëzimet e shumta të të qenit mysafirë dhe nikoqirë, gjë që hapi udhë për pikëpamje të reja, përtej situatave ku ishim. Solidariteti midis komuniteteve ishte faktori kryesor për t'u siguruar që ata nuk ktheheshin në shtëpi kokëulur, si viktimat të sulmeve që kundërshtuan themelet e këtij edicioni të documenta. Si reagim ndaj vështirësive, ishte e rëndësishme që ata të kishin edhe përvoja pozitive, përkushtime të forta, përgjegjësi dhe përkrahje. Për OFF-Biennale, kjo vizitë solli miq të rinj, aleatë, dije dhe një numër temash, komunitetesh, krijuesish, si dhe mblodhëm përshtypjet e të tjerëve, që

thonin se mënyra e punës siç e kemi menduar dhe jetuar ne, është në fakt fundamentale për shumë partnerë globalë, pra, ne nuk po i jetojmë disa ëndrra naive, por një realitet tjetër të përbashkët.


Ne ishim mysafirë dhe falë bujarisë së nikoqirëve, ne ishim nikoqirë vetë—në dhomat e mëdha të Fridericianum, të sjella në jetë nga shkolla lumbung dhe në shtëpinë-anije Ahoi! (një tjetër hapësirë e documenta pesëmbëdhjetë) në brigjet e Fulda, ku përbrenda një projekti që tematizon këndet e lojërave, ne ftuam këdo që e konsideron lojën si mënyrë të jetesës.

Ura që e ndërtuam me Recetas Urbanas (the Allesbrücke, Ura e gjithçkafit), e cila të çonte përmes ndërtesës së shtëpisë-anije drejt sferës së fantazisë, ishte një tribut ndaj mikpritjes së nxënësve të një shkolle lokale. Ne i ftuam ata dhe ata na mirëpritën duke na lënë jo vetëm brenda shkollës së tyre, por edhe brenda vizioneve e tyre, problemeve që i kishin përjetuar dhe ideve e planeve të tyre. E gjithë kjo u ngrit në qiell prej Urës së gjithçkafit, jeta e së cilës vazhdoi në oborrin e shkollës edhe pas përfundimit të documenta.

Bujaria dhe besimi i nikoqirëve hapi mundësinë që ne t'i ftonim mysafirët tanë. Dhe këtu, rrjeta e ndërlikuar e lidhjes nikoqir-mysafir u shpërfaq: Si ruangrupa, nikoqiri ynë tashmë ishte mysafir në Kassel, ne ishim mysafirët e tyre, teksa, në të njëjtën kohë, ne ishim po ashtu mysafirë të qytetit dhe të komuniteteve lokale. Pas një kohe, bëhet e vështirë të kuptohet se kush ndan çfarë burimesh, cilat prej tyre mund t'i konsiderojnë të vetat dhe çfarë privilegjesh ata njohin dhe refuzojnë. Refuzimi këtu nuk i bie humbje, por bartje, pra pasurim. Po ashtu, deri në një masë, i bie heqje dorë nga kontrolli në proces, pasi ky lloj i shoqërisë së ndërtuar në besim, ky eskalim i mikpritjes, nuk i lë vend kontrollit të gjithëmbarshtëm të vështimit qendror. Me këtë liri, neve jo vetëm që na u dhanë mundësitë, por edhe një ndjesi e përgjegjësisë për mysafirët tanë, të cilët, megjithatë, nuk duhet të bëhen mjete të kontrollit dhe censurës, mjete të zbehjes së autonomisë së mysafirit.

U kthyem nga ai udhëtim me shumë bagazh—shumë përvoja, mësim, por edhe dyshime—dhe mikpritja që e përjetuam prej anëtarëve të lumbung, artistëve dhe fëmijëve, mikpritje të cilën jemi të përkushtuar ta ndajmë me të tjerët, është me gjasë, gjëja më e rëndësishme që e kemi marrë.

Mënyrat e ballafaqimit me dallimet



Komunikimi, qoftë midis fëmijëve apo të rriturve, kërkon punë. Qoftë nëse jemi duke kërkuar mirëkuptim, miqësi, përcaktim të kufijve ose thjesht përçim të një mesazhi, procesi kërkon kujdes. Është e rëndësishme për ne që të ndihmojmë të rriturit dhe fëmijët prej prapavijave të ndryshme kulturore dhe shoqërore që t'ia dalin mbarë në këtë proces. Prosesi i ballafaqimit me dallime është i vazhdueshëm dhe konstant, edhe pse shpesh del në sipërfaqe në momentet kur ka konflikte. E pyetëm Tereza Havlínovká për një opinion nga jashtë se si të ballafaqohemi me dallimet. Ajo fotografoi kampin kreativ për fëmijët “The Great Land of Small” (Toka e madhe e të vegjëlve), që zuri vend në Pragë, Çeki, në verën e vitit 2024, si pjesë e Biennale Matter of Art, organizuar nga tranzit.cz.

Tereza S.: A ke pasur një ide të paracaktuar se çka do të fotografosh?

Tereza H.: E dija se ishte një kamp i fëmijëve dhe që isha aty për të fotografuar aktivitete grupore në kamp. E dija që do të kishte fëmijë nga Praga dhe Ostrava dhe e dija që fëmijët nga

Ostrava kishin shkuar në kamp si grup. Por, për çka brengosjesha kryesisht, ishte se si të fotografoja brenda—çfarë drite do të kishte e kështu me radhë.

Tereza S.: Në fakt, ishin tri grupe. Ishin fëmijët nga Praga 7, të cilët ishin regjistruar nga prindërit e tyre, pastaj ishin fëmijët nga Ostrava, me të cilët ramë në kontakt falë kolektivit TV Páteř dhe pastaj, fëmijët ukrainas.

Tereza H.: Oh, e vërejta vetëm dallimin midis fëmijëve nga Praga dhe atyre nga Ostrava. Fëmijët nga Praga ishin sjellur aty nga prindërit e tyre, por fëmijët nga Ostrava erdhën në grup dhe ishte e qartë që ishin romë dhe që prindërit e tyre nuk kishin ardhur me ta. Ata kishin ardhur me disa ndihmëse. Në fillim, ndihmëset nuk dëshironin që unë të bëja fotografi. Edhe pse e dinin se isha me tranzit, e ndieva një brengosje dhe një frikë për fëmijët, të cilët fotografoheshin—një frikë të eksploatimit dhe abuzimit nëse fotografitë do të publikoheshin online. Por në të njëjtën kohë, nuk kishte kuptim t'i lija vetëm fëmijët romë pa fotografuar. Nëse do t'i fotografoja të gjithë përpos fëmijëve romë, atëherë do t'i përjashtoja ata. Por e kuptoj që gratë ishin përgjegjëse për fëmijët, prandaj ishin të kujdesshme. Por pastaj, e kundërta ndodhi. Shpejt u bëra personi më interesant aty dhe në fakt fëmijët nga Ostrava ishin më kureshtarët rreth meje. Ata interesoheshin për gruan me aparatën e madh fotografik dhe iu dukej argëtuese të dilnin në fotografi. Më duhej t'ua shpjegoja që duhej t'i fotografoja edhe të tjerët. Kështu, kalova nga përpjekja për të kuptuar nëse kishte kuptim t'i përjashtoja fëmijët romë nga fotografitë te përpjekja që t'i shmangem fotografimit të vetëm një grupi të vogël fëmijësh. Por edhe në grupin nga Ostrava kishte fëmijë që ishin më të turpshëm dhe më të tërhequr. Por, në përgjithësi, ndërveprimi me fëmijët nga Ostrava ishte më i lehtë—ata ishin më të interesuar në mua, dëshironin të dinin se çka po bëja aty, çka po fotografoja dhe se si po fotografoja, ku jetoja, nga ku vija e kështu me radhë. Ata flisnin më shumë me mua.

Tereza S.: A kishte ndonjë gjë tjetër që e vërejte?

Tereza H.: Çka doli në pah—siç ndodh zakonisht në çfarëdo hapësire të ngjashme mësimi—ishte prapavija e secilit fëmijë: sa shumë ata ishin të aftë që të bashkëpunonin, të kuptonin se çka kërkohet nga ta. Mund të shihje që disa fëmijë ishin të familjarizuar me aktivitete të ngjashme e disa më pak. Por mosha dhe personaliteti i secilit fëmijë mund të luajë rol gjithashtu.

Tereza S.: Si do t'i përshkruaje marrëdhëniet midis fëmijëve?

Tereza H.: Kishte një pengesë gjuhësore. Disa nga fëmijët flisnin ukrainisht—mendoj që ishte më e lehtë për ta—dhe të tjerët nuk e kuptonin fare atë gjuhë. Mendoj që në përgjithësi, grupet nuk përziheshin shumë—pos një djali nga Praga, i cili kishte ambicie të mëdha udhëheqësie dhe po provonte t'i menaxhonte të gjithë aty, prandaj ai komunikonte me të gjithë. Madje, provonte të më jepte detyra e të më kontrollonte edhe mua. :)


Kam empati të lartë për njerëzit që disi duken të pafavorizuar në shoqëri. Kjo është arsyseja pse isha, në mënyrë të veçantë, e brengosur për fëmijët nga Ostrava. Isha më amënë karshi tyre, më e vëmendshme ndaj mënyrës se si trajtoheshin ata, si i trajtoja vetë ata. Por pastaj nuk më erdhi mirë kur ata filluan të talleshin me një vajzë nga Praga, e cila kishte flokë të shkurtëra. I bërtitnin duke i thënë se ishte lezbike dhe këtë e nënkuptonin si ofendim. Më dukej se kjo ishte diçka për të cilën nuk dinin se çfarë të bënin, diçka që nuk u kishte ndodhur më parë, prandaj po përdornin diçka që e kishin dëgjuar diku në hapësirën publike në lidhje me gratë më flokë të shkurtëra. Dhe kështu, ata vendosën ta përballnin atë vajzë me faktin që ajo iu dukej e çuditshme. Më dukej se nuk ishte roli im të ndërhyja—mbi të gjitha, isha aty për të fotografur. Por në një nivel njerëzor ndieja se çka po ndodhte ishte gabim dhe se duhet të ndërhyja. Kishte të bënte me faktin se edhe unë kisha flokë të shkurtëra dhe e di se sa e parehatshme është kur njerëzit e komentojnë atë gjë. Ndodh kur i ke 13 vjet, e edhe kur i ke 30 dhe burrat, gratë dhe fëmijët, të gjithë e komentojnë këtë gjë, prandaj nuk është një sulm që vjen nga një grup specifik i njerëzve. E pashë si ofendim dhe një dëshmi që këta fëmijë, në njëfarë mënyre irritoheshin prej mënyrës se si kjo vajzë dukej. Në atë moment, ndieja empati për dikë që po përjetonte një sulm vetëm për shkak të mënyrës se si dukej, gjë që, mendova, me siguri ishte diçka për të cilën ajo vajzë nuk ishte as e vetëdijshme. Në ambientin ku ajo jeton, në ndonjë komunitet diku në Pragë, flokët e saj me siguri nuk janë aq të vërejtshme.

Tereza S.: Me sa e di, ishte hera e parë që ajo dëgjonte fjalën lezbike dhe ishte mjaft e hutuar nga sjellja e tyre. Nuk e kuptonte. Por po ashtu më tregoi se edhe fëmijët në shkollën e saj ia komentonin flokët, prandaj nuk ishte diçka e re për të.

Tereza H.: E ndieja se mund të ishte e nervozuar me disa fëmijë, të cilët nuk i kishin mjetet të kuptonin dhe shihnin se çka po bënin. Nuk dëshiron ta shohësh askënd si sulmues—nuk dëshiron të mendosh për njerëzit si të këqinj sepse mund ta

shohësh prej nga vjen ai keqkuptim. Por nuk mund të bësh asgjë në atë moment dhe aty. Dhe, për më shumë, në rolin tënd, nuk je as në pozitë që të ndërhysh dhe nuk e di se si. E di se kjo situatë duhet të zgjidhet disi, por ti nuk je personi përgjegjës—nuk jam as e përgatitur e as e trajnuar për këtë situatë. Situata m'i kujtoi dy dokumentarë që i kam parë: *The Impossibility* (Pamundësia) dhe *Dajori*. Të dy filmat janë të padurueshëm; kanë të bëjnë me njerëz që përballen me probleme, të cilat nuk kanë fuqi t'i zgjidhin. Të dy filmat kanë të bëjnë me familje rome, por janë realizuar nga njerëz të bardhë. Situata ime ishte ndryshe; nuk më duhej të përballesha me çështjet etike me të cilat përballen filmbërësit—e kisha një punë dhe kaq. Por si një filmbërës jo-rom, a ke të drejtë të portretizosh rrëfime të atilla në kinematografi? Po ndërhysh në jetën e dikuj, po i detyron të ballafaqohen me situatën e tyre, gjë të cilën ndoshta as nuk kanë kapacitet e as fuqi ta bëjnë. Çfarë mundësie kanë ata që ta përfaqësojnë veten në prodhimin audio-vizual? I kisha gjithë këto pyetje. A nuk është ky lloj i inxhinierisë shoqërore në sferën kulturore një thikë me dy teha? A e ka kuptimin dhe mbulueshmërinë, që do të na pëlqente ta kishte? A nuk është kjo e padobishme, e ndjeshme, e rrezikshme për të dy palët?

Ndërthurja



Për ta përkufizuar termin ndërthurja, e kemi përkthyer një pjesë nga protokoli feminist i La Escocesa, i cili trajton dhunën në baza gjinore, diskriminimin dhe konfliktet që lidhen me gjini. Protokoli është shkruar nga Genera, një shoqatë që mbron lirinë dhe të drejtat seksuale dhe gjinore dhe specializon në konsulencë feministe.

Ndërthurja është një term fillimisht i përdorur nga Kimberlé Crenshaw, në vitin 1989. Është një mjet që na e mundëson të analizojmë se si shtypjet strukturore ndërthuren në një kontekst shoqëror. Qëllimi i ndërthurjes është që të ofrojë një vizion më kompleks sesa një analizë të përqendruar vetëm në një çështje të veçantë (si për shembull, përqendrimi vetëm në gjini si boshti shpjegues për gjithçka), derisa në të njëjtën kohë, shërben për të analizuar format e ndryshme të dominimit të pushtetit. Kështu, ndërthurja na e ofron një pikëpamje për të kuptuar se si kategoritë e reja shoqërore shpërfaqen dhe se si pabarazitë dhe/ose përparësitë shoqërore formohen në udhëkryqet, ndërthurjet e tyre. Kjo na tregon se ku janë të vendosur akterët shoqërorë përbrenda marrëdhënieve të pushtetit në kontekste specifike socio-historike dhe se si ata kanë pikëvështrime të ndryshme për çështje të ndryshme shoqërore.

Ndërthurja na ndihmon të kuptojmë se si dallimet po ashtu formësojnë trajektore të përjashtimit/përfshirjes së ngadaltë dhe, si rrjedhojë, janë të vendosura në mënyrë asimetrike përmes sistemeve si patriarkia, homofobia, transfobia, klasizmi, racizmi apo aftësisizmi (diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar).

Çka përfshin ndërthurja dhe si mund të punojmë me të përbrenda një kornize institucionale ose kolektive?


- Merrni parasysh cilat boshte të dominimit janë relevante në raste të dhunës apo ngacmimit. Nuk ka të bëjë me vendosjen e ndërthurjes te njerëzit, por ka të bëjë me vëmendjen që i kushtohet faktit se si faktorët e ndryshëm strukturorë si seksizmi, klasizmi, racizmi apo

statusi i shtetësisë (origjina dhe situata administrative), ndër tjera, e ndikojnë rastin.

- Kuptoni dhe adresoni cenueshmërinë duke u përqendruar jo vetëm në personin, por kryesisht në strukturat që e ushqejnë atë cenueshmëri specifike të gjinisë, racës, shëndetit apo lidhjes së tyre me strukturat tjera të pushtetit.
- Kuptoni se mënyra se si propozohen ndërhyrjet dhe shërbimet, si dhe mënyra e të të kuptuarit të dhunës dhe rikuperimit të grave ndikohet nga konteksti shoqëror dhe material dhe shpeshherë u përgjigjet kritereve sipas nevojave të grave, situata e së cilave shihet si “normale” (zakonisht atyre më të privileguara)
- Kushtojini vëmendje të veçantë qasshmërisë së shërbimeve tuaja, mësoni rreth pengesave materiale dhe simbolike dhe mendoni për veprimet e nevojshme për t’iu qasur atyre më në rrezik.
- Kuptoni nevojën për ta analizuar dhunën në terma të ndërthurjes, sidomos në raport me kushtet ekonomike, strehimin dhe situatën administrative, që e përjetojnë ata/o që përjetojnë dhunë.
- Sigurohuni që i merrni parasysh të gjithë faktorët që mund ta ndikojnë përkujdesjen ndaj personit (si për shembull, shërbimet publike që po dështojnë të kujdesen për ta, për shkak të paragjytimeve, frikën nga prania e policisë për shkak të mungesës së statusit ligjor administrativ, etj.).
- Kur përqendroheni në një person, merrni parasysh se cilat strategji të ndërhyrjes mund të riprodhojnë marrëdhëniet e pushtetit. Është e nevojshme që mjetet që i zhvillojmë të mos jenë të ndërtuara sipas modelit të dëmshëm të dhunës sistematike, por të jenë asisoci që krijojnë hapësirë për agjenci dhe fuqizim.

Protokolli feminist mëton të jetë një mjet për transformim dhe ndryshim shoqëror, jo vetëm në raport me situatat specifike që mund të ndodhin në La Escocesa, por për çfarëdo agjenti kulturor që promovon idetë e feminizmit dhe të drejtësisë transformuese. Kjo qasje mundëson, në njërin anë, që çdo njeri i prekur, të vendoset në qendër të ndërhyrjes dhe, në anën tjetër, që të mbrohen parimet që i konsiderojmë më etiket dhe më të dobishmet për kujdes individual dhe transformim shoqëror e komunitar.

Aleancat



Çkado qofsh — artist/e, punonjës/e kulturor/e apo institucion arti, nuk mund të shkosh larg i/e vetëm/me. Dhe kjo është edhe më e sigurt nëse je i/e përfshirë në projekte pjesëmarrëse, të përfshira dhe të përkushtuara në aspektin shoqëror. Këto mund të jenë aleanca me njerëz që mendojnë ngjashëm ose pozita qëllimshëm të zgjedhura për të plotësuar njëri-tjetrin. Aleancat formohen për periudha të ndryshme kohore; disa thjesht zgjasin derisa të përfundojë projekti, teksa të tjerat zhvillohen në periudha më të gjata, mbase pa një afat të caktuar. Sidoqofshin ato, aleancat kërkojnë vëmendje dhe duhen ushqyer.

Nëse jeni ju ata/ato që e inicioni një aleancë, ka shumë gjasë që i ndani qëllimet në plotni. Megjithatë, nëse ftoheni për t'u bërë pjesë e një aleance, shumë pyetje lindin dhe duhet të qartësohet nëse qëllimet janë të përputhshme me qasjet dhe vlerat tuaja. Një çështje tjetër është se sa kohë apo energji keni vullnet t'i kontribuoni.

Duke qenë se kjo është një temë, ku njëmend deshëm t'i shqyrtojmë pikëpamjet e disa prej aleatëve tanë, vendosëm ta shtjellojmë termin përmes disa zërave. Kjo është pjesë nga një bisedë më e gjerë midis Ajete Kërqelit nga Fondacioni 17, Anton Lederer nga < rotor > dhe Tereza Stejskalová nga tranzit.cz rreth aleancave.

Ajete: Kur është fjala për aleancat, ne u qasemi atyre me një ndjesi të baraspeshës, duke u siguruar që të mos jemi as krejtësisht të përfshirë e as krejtësisht të shkëputur. Përpiqemi të qëndrojmë të angazhuar mjaftueshëm për t'i kuptuar dinamikat, por edhe mundohemi të mbajmë distancën e

nevojshme për të ruajtur qartësinë dhe këndin e vështrimit. Aleancat i shohim si korniza stabile, afatgjata, që na ofrojnë mbështetje përgjatë kohës. Derisa gjithnjë jemi gati të përgjigjemi në kohë urgjencash, qëndrojmë të përkushtuar në mbajtjen e një pikëpamjeje më të gjerë, më strategjike. Si fondacion, synojmë të bashkëpunojmë me grupe që janë pro-aktive—ata/o që veprojnë me qëllim, që parashikojnë nevojat në vend se thjesht të reagojnë. Marrë për bazë kompleksitetin e përgjegjësisë tona, përpiqemi të jemi të vëmendshëm ndaj rrezikut për lodhje të tepërt (burnout) pasi mund ta ndikojë aftësinë tonë për të kontribuar në mënyrë kuptimplote dhe në aftësinë tonë për t'i bërë të qëndrueshme përpjekjet tona.

Anton: Sa po flisim për aleancat më komplekse me shumë akterë dhe me zhvillim afatgjatë. Kjo është ndryshe prej projektit tonë të përbashkët, Art Space Unlimited, i cili e ka një kornizë të caktuar kohore. Ky aktivitet ndodh dhe pastaj përfundon. Por, këto aleanca për të cilat po flasim—kurrë nuk e dimë në fillim se sa, në fakt, do të zgjasin. Mendoj, për shembull, që aleanca kundër të djathtës ekstreme mund të jetë e nevojshme për një kohë shumë të gjatë. Pastaj duhet ta konsiderosh investimin tënd personal, sa mund të kontribuosh—jo të jesh i pranishëm vetëm për disa muaj, por ndoshta për vite të tëra.

Tereza: E kam një imazh të asaj për të cilën po flisni; është metafora e babait, i cili nuk është i pranishëm. Babai që s'është i pranishëm nuk është aty, por pastaj papritmas ai vjen, i sjell gjithë ato dhurata, i plotëson gjithë ato dëshira, është argëtues, por pastaj lodhet mjaft shpejt dhe zhduket për një kohë të gjatë, ndoshta përgjithmonë. Ndërkohë, nëna është aty vazhdimisht, ajo nuk është aq argëtuese; është mjaft strikte dhe ka kufij të qartë rreth asaj që mund ta bëjë për ty, por ajo është aty.

Anton: A jam unë nëna?

Tereza: Po, sepse ti mund të kontribuosh në mënyra të vogla ndoshta, por je prani e besueshme—njerëzit e dinë që do të jesh aty për afat të gjatë.

Ajete: Unë i shoh aleancat si partneritete dinamike. Secila palë sjell pikëpamjet dhe prioritetet e veta unike, por ka një themel të përbashkët që na mban bashkë për një bashkëpunim afatgjatë. Partneritetet e përkohshme, anipse të vlefshme, mund të jenë një hap drejt ndërtimit të aleancave më të forta, më të qëndrueshme. Aleancat e njëmendëta shkojnë përtej një qëllimi të vetëm apo reagimit të menjëhershëm, duke u përqendruar në bashkëpunim të qëndrueshëm përgjatë kohës.

Anton: Një shoqe imja, artistja Isa Rosenberger nga Vjena, flet për “aleancat e përkohshme”. Kjo është një strategji që ajo e zhvilloi në projektin e saj bashkëpunues me gra. Ajo thotë që disa prej grave mund të bëhen shoqe pas projektit dhe, mbase, bëjnë diçka bashkë. Aleancat e këtilla të përkohshme zgjasin disa muaj, ndoshta një vit dhe kështu e ke një rezultat. Por pastaj mund të vazhdojë dhe një aleancë e përkohshme mund të bëhet aleancë afatgjatë. Një herë, patëm ftuar një qendër feministe për një projekt. Në atë kohë, nuk mund të flisnim për një aleancë, por ishim tashmë mjaft të afërt me institucionin për shumë vjet dhe kështu, në fund doli të ishte njëfarë aleance. Në raste tjera, ftojmë njerëz për një bashkëpunim dhe asgjë nuk ndodh pastaj, për arsye të ndryshme.

Tereza: Sa striktë duhet të jemi në aleancat tona? A duhet që gjithnjë t’u qëndrojmë besnikë vlerave tona themelore apo duhet të jemi më fleksibilë? A i vëreni dallimet midis aleancave me njerëz nga fusha e artit dhe aleancave me njerëz nga fushat tjera?

Anton: Mund të ketë një lloj tensioni të pavetëdijshëm me kolegë nga fusha e kulturës, sidomos midis atyre që punojnë në qytetin e njëjtë. Operojmë në fushën e njëjtë, u qasemiburimeve dhe fondeve të njëjta, e ndajmë një pjesë të audiencës. Përpiqem ta tejkaloj këtë atmosferë, por nganjëherë është aty. Kur isha punonjës i ri kulturor, e ndieja më fort; tensioni ishte mjaft i lartë, por kohëve të fundit është më mirë. Brezat e rinj tregojnë më shumë solidaritet dhe besojnë më shumë në aleanca. Bashkëpunimi në aleancë me organizata nga fushat tjera—si nga edukimi ose rinia, kultura apo migrimi—përfshin më shumë përparësi. Jeni më kureshtarë për njëri-tjetrin dhe është ajo ndjenja që mund të mësoni më shumë nga njëri-tjetri.

Tereza: Po, ti e njeh fushën në të cilën punon, por mund të mos dish aq shumë për fushat tjera. Në fushën kulturore mund t’i marrësh disa gjëra për të mirëqena apo edhe të supozosh për gjëra të caktuara. Në fusha tjera, është proces i të mësuarit. Mëson rreth asaj se si bëhen gjërat tjetërkund; dëgjon dhe nuk bën shumë supozime.

Ajete: Çka me të vërtetë ka rëndësi është urgjenca e përbashkët dhe përkushtimi që qëndron prapa aleancës. Nëse qëllimi është prioritet kryesor për të dy palët, atëherë fusha prej nga vijmë—qoftë arti, qoftë ndonjë sektor tjetër—bëhet dytësore. Çka e shtyn përpara një bashkëpunim është vendosmëria e përbashkët për të vepruar.

Kundër përqendrimit vetëm te të rriturit

Fëmijët janë brez tjetër; të jesh me ta do të thotë të jesh i/e pranishëm/me teksa ky brez lind. Askush nuk e ka një recetë se si t'i përgatisë fëmijët për jetë në një botë që po del prej kontrollit—si t'i përgatisë fëmijët për një të ardhme tërësisht të mjegullt. Mbase sot, nuk kemi tjetër zgjidhje pos t'i dëgjojmë fëmijët dhe të ndikohemi prej tyre. Kjo ide nuk është e re; në fakt, ishte qendrore në dy eksperimente pedagogjike dhe institucionale të shekullit XX në rajonin tonë—shtëpia e fëmijëve e Janusz Korczak në Varshavë dhe Republika Gladiopolis për jetimët e luftës në Budapest. Të dyja këto nisma po ashtu synuan emancipimin e fëmijëve përmes botimit të gazetave të fëmijëve, të cilat i organizuan dhe në të cilat kontribuan vetë fëmijët. Këto botime ishin një mënyrë e fëmijëve për t'ua komunikuar vizionet, idetë dhe qëndrimet e tyre fëmijëve tjerë, si dhe të të rriturve/ave. Ofrimi i hapësirës për fëmijët që të shprehen vetë, në mënyrën që ata zgjedhën ishte emancipuese, edhe për fëmijët, e edhe për të rriturit/at e përfshirë në këto nisma. Këto ishin përpjekje për ta sfiduar dinamikën tradicionale midis të rriturve/ave dhe fëmijëve. Biseda në vijim e ndjek të njëjtën qasje. Në të, vajza ime dhjetë-vjeçare intervistoi miqtë e saj, duke treguar se si zërat e fëmijëve ende mund të ofrojnë dije për botën e tyre sot.

N (mosha 10): Çka mendon se do të ishte çlirim për fëmijët?

Ni (mosha 7): Së pari, nuk do të kishte shkollë. Së dyti, nuk do të na duhej të merrnim urdhra nga prindërit tanë. Së treti,

gjithçka do të ishte falas—por veç për fëmijët, jo për të rriturit. Lodrat do të ishin falas, por jo për të rriturit. Nuk do të kishte detyra të shtëpisë.

N: Cila lëndë shkollore të pëlqen më së paku?

Ni: Gjuha çeke.

N: Çka do të bëje në vend të shkollës?

Ni: Pushime. Dhe pas pushimeve, më shumë pushime.

N: Dhe çka do të bëje gjatë pushimeve?

Ni: Do të doja të mërzitesha në pushime, do të rrija shtrirë diku. Dhe nëse nuk do të ishte e mundur dhe nëse do duhej pa çare të shkonim në shkollë, të paktën do të duhej të mund t'i zgjedhim lëndët dhe nuk do të kishte detyra të shtëpisë. Mund të ndjeknim pak gjuhë çeke, për shembull. Dhe do të mund të kishte pushime gjatë orës mësimore.

N: E për lodrat—çka do të bëje nëse edhe prindërit tu do të donin gjëra falas?

Ni: Unë do të kisha gjithçka falas dhe do të mund t'ua jepja atyre.

★★

N: J, çka do të thotë t'i lirosh fëmijët për ty?

J (mosha 7): Çlirim për mua do të ishte nëse s'do të kishim shkollë e as detyra të shtëpisë. Do të kishim pushime gjatë tërë vitit, do t'i kishim lodrat që i duam, dhomat që i duam—gjithçka falas. Ose shkolla do të mbahej vetëm të hënave, mërkureve dhe të premteve. Dhe pushimi do të ishte pak më i gjatë, ndoshta katër muaj—qershor, korrik, gusht, shtator.

N: E çka do të bëje në pushime?

J: Do të shkoja te shoqet/shokët, në udhëtime, nëpër kështjella, muze, teatër, do t'i vizitoja gjyshet dhe do ta festoja ditëlindjen.

N: Dhe çfarë lodre do të doje nëse do të kishe mundësi të zgjedhësh?

J: Një papagall kukull. E kam pasur një zog dhe iu thye koka.

N: E cila është lënda që të pëlqen më së paku?

J: Matematika.

★★

N: L, si mendon se do të dukej çlirimi i fëmijëve?

L (mosha 8): Të gjithë do të merrnin fëmijë nga jetimorja në shtëpi dhe ata fëmijë do të kishin mjaftueshëm para dhe ushqim. Do të ishin me familje sërish dhe do të kishin gjëra që i bëjnë të lumtur. Fëmijët do të mund të mësonin çkado që duan. Mësuesit/et do t'i pyesnin fëmijët, "Fëmijë, çka dëshironi të mësoni sot?" Dhe fëmijët do të vendosnin vetë.

N: Pra, ti do të doje të shkosh në shkollë, por do të doje t'i zgjedhësh vetë lëndët. Cila është lënda më pak e preferuar?

L: Me siguri, gjuha çeke.

N: A nënkupton çlirimi i fëmijëve ndonjë gjë tjetër për ty?

L: Të varfërit do të kishin para. Gjërat që janë tepër të shtrenjta do të ndaloheshin sepse ka fëmijë që nuk mund t'i kenë ato gjëra dhe kjo i pikëllon ata shumë. Për shembull, nëse do të shkosh në një kënd lojërash dhe të flesh atje do të të kushtonte 100,000 dhe disa fëmijë të varfër duan të shkojnë? Oh, jo! Nuk do të doja që ne të ishim xhelozë. Po ashtu, do të doja që të rriturit të kenë respekt për fëmijët—që të mos jenë të pasjellshëm me ta. Ata duhet të jenë shumë të mirë me fëmijët. Do të doja që të mos kishte hajna.

N: Si do të mund të të trajtonin më mirë prindërit tu?

L: Më pëlqen se si më trajtojnë tani. Janë të mirë me mua, por janë edhe rigorozë. Fëmijët nuk duhet të lazdrohen; edhe ata duhet t'i lajnë enët nganjëherë. Nuk duhet që vetëm prindërit t'i lajnë enët.

★★

N: V, çka i bjen për ty çlirimi i fëmijëve?

V (mosha 8): Jashtë shkollës, jashtë gjithçkaje, i urrej të gjitha. Nuk më pëlqen lënda e gjuhës çeke, nuk më pëlqen madje as matematika. Më pëlqejnë gjimnastika dhe pushimet—kaq. Asgjë tjetër në shkollë nuk më pëlqen. Do të doja të udhëtoja në vend se të shkoja në shkollë.

★★

N: T, çka nënkupton për ty çlirimi i fëmijëve?

T (mosha 4): Nuk do të shkoja në çerdhe. Me gjasë, kjo është gjëja më e keqe në botë.

N: Nuk të pëlqen çerdhja?

T: Jo.

N: Çka do të bëje në vend të çerdhes?

T: Çerdhja duhet të shkatërrohet nga një top gjigant betoni.

N: E çka do të bëje ti nëse nuk do të shkoje në çerdhe?

T: Do ta bleja një monster-dragua në telefonin e babit tim dhe do të luaja.

N: Do të luaje lojëra me monster tërë ditën?

T: Nuk e di. M'u shpenzuan idetë.

★★

K (mosha 14): Do të doja që të rriturit të fillojnë t'u besojnë fëmijëve. Ata duhet të mos thonë më se janë vetëm fëmijë të vegjël me tepër shumë imagjinatë.

★★

Ni: N, e për ty?

N: Do t'i doja dy vite pushime. Dhe do të doja që të kisha gjithçka falas. Ashtu që të mund të blenim çkado që duam. Do të doja të mund t'i ngjyrosja muret e dhomës sime—shumë do të doja ta ngjyrosja dhomën.

T (mosha 43): E çka do të ndodhte pas dy vitesh pushim?

N: Pastaj, do të vinte një pushim tjetër.

T: Pra, do të ishte një pushim pafund?

N: Po, do të ishte shumë mirë.

T: E si do të dukej dita jote?

N: Do të zgjohesha, do t'i pastroja dhëmbët, haja mëngjes, do të vishesha dhe pastaj ndoshta do të dilja me shoqëri. Do të shkoja në parkun Gutova, ku do të luanim. Pastaj do të ktheheshim në shtëpi dhe do të hanim drekë....

T: E kush do të gatuate për ty?

N: Nëna dhe babai. Pastaj do të mund të dilnim për çaj me flluska me prindërit dhe pastaj do të shkonim për një shëtitje.

T: Pra, prindërit nuk do të punonin?


N: Jo, nuk do të punonin sepse paratë do të binin nga qielli.

T: Mirë. E çka do të bënin ata?

N: Do të kalonin më shumë kohë me ne fëmijët. Do të shkonim në disko në mbrëmje, të vallëzojmë dhe pastaj do të ktheheshim për të fjetur. Por edhe do të mund të shkonim diku. Do të mund të udhëtonim.

T: Ku do të doje të shkosh?

N: Itali, Gjermani, Vietnam ose Japoni.



Parafytyrimi

Parafytyrimi është një praktikë shoqërore, në të cilën organizata të ndryshme të shoqërisë civile dhe lëvizjet shoqërore, jo vetëm që kërkojnë ndryshim në sistemin ekzistues institucional, por po ashtu e jetojnë botën e imagjinuar të së ardhmes, në të tashmen. Ato nuk imagjinojnë një utopi të largët, por i gërshejtojnë përbrenda jetës së përditshme parimet dhe strukturat përbrenda së cilave duan të jetojnë. Bota e dëshiruar nuk është një qëllim për t'u arritur, por një realitet në bërje e sipër.


Imagjinoni një kopsht që po e ndërtoni për të ardhmen—një ku bimët u përshtaten ndryshimeve mjedisore dhe janë tolerante ndaj kushteve ekstreme të jetës, prandaj mbijetojnë. Për të krijuar një kopsht, na duhet të marrim një pjesë të natyrës dhe ta ndryshojmë atë sipas imagjinatës sonë. Duke e kufizuar atë përreth, në krijojmë jo vetëm një kufi fizik, por edhe simbolik midis natyrës dhe mjedisit të bërë nga njeriu. E ndërtojmë një botë tonën brenda gardhit, e lidhur me botën jashtë përmes një mijë fijeve të padukshme: komunikimi midis mikroorganizmave në dhé dhe rrënjët e bimëve na e kujtojnë që lidhja midis kopshtit dhe natyrës—midis botës së jashtme dhe botës së brendshme—nuk ndalon për shkak të kufijve. Kopshti është (si) një kënd lojërash—një vend ku një botë imagjinare dhe realiteti takohen. Që të dyja janë njëfarë modeli i botës, rregullat e së cilës formësohen sipas asaj që e mendojmë për botën dhe veten tonë në të ose sipas mënyrës se si e imagjinojmë botën. Është një hapësirë e fantazisë ku gjithçka është aq reale sa edhe joreale, por prapëseprapë pak ndryshe. A mund ta shohim kopshtin si model i funksionimit organizativ parafytyrues, model që është i ndjeshëm ndaj ndryshimeve shoqërore dhe mjedisore përreth, ku bota e gjallë, e mbështetur në ligjet e veta të brendshme, zbaton praktika të qëndrueshmërisë, bashkëpunimit dhe solidaritetit?

Që nga themelimi, në vitin 2014, OFF-Biennale Budapest u ka dhënë rëndësi temave si liria, loja, ndërtimi i komunitetit, demokracia, solidariteti dhe pavarësia e punës kreative. Duke përdorur përfytyrimin si një strategji të funksionimit, punon për të zhvilluar një model ku i sfidon normat ekzistuese sociale, të rrënjosura në mekanizma që kanë tendencë të bëjnë kompromise, si dhe planifikon për të ardhmen, gjë që e bën duke ndërtuar prej së tashmes, pavarësisht ambientit të pasigurt institucional. Kërkon praktika se si të imagjinohen gjërat ndryshe.


OFF-Playground (OFF-Këndi i lojërave), ndërtuar si pjesë e projektit “WHATIFS AND WHYNOTS: OFF-Playground” (ÇKANËSET DHE PSEJOTË: OFF-Këndi i lojërave) në dokumenta pesëmbëdhjetë në vitin 2022, derisa krijonte kushtet për një aventurë të përbashkët, ishte po ashtu një eksperiment serioz. Eksperimentoi me politika përfytyruese duke besuar se, përbrenda gardhit, një kënd lojërash me hapësira, praktika dhe mendime të propozuara nga artistët—një rrjet i ndërveprimeve—mund të krijohet jo duke e kapërcyer realitetin, por në fakt, me qëllimin që të krijohet një realitet, ku ëndrra kthehet në përjetim. Duke krijuar një hapësirë “imagjinare” dhe duke bërë atë që ne bëjmë në të, ne u ofrojmë të tjerëve mundësinë që ose ta zgjedhin vendin e tyre në atë hapësirë ose të krijojnë ishuj të rinj, hapësira të veta. Shpresojmë që këta ishuj, një ditë do të jenë të lidhur. Rregullat e lojës krijojnë një terren të përbashkët dhe shpresojmë që njerëzit që mendojnë ngjashëm, do të na bashkohen. OFF “luan” institucionalisht përmes projekteve dhe vizioneve të ndryshme kuratoriale dhe artistike, nëpërmjet bashkëpunimeve shoqërore. Ne sillemi sikur të ishim një institucion artistik i madh, ndërkombëtar, me një bazë solide financiare dhe burimore, si dhe me një ambient mbështetës. Ne “performojmë” dhe “parafytyrojmë” një institucion të pavarur, kapitali më i fortë i së cilit është vizioni i përbashkët.

Politikat parafytyruese, si në rastin e këndit të lojërave dhe kopshtit, përdoren për ta mbushur hendekun midis “imagjinatës dhe jetësimit”, që i bie të përpiqemi të ndërtojmë një ndryshim në të ardhmen e imagjinuar, në një mënyrë të vogël, këtu dhe tani. Megjithatë, kjo qasje, nganjëherë, pashmangshëm bëhet e lodhshme dhe motori ngadalësohet. Kornizat e vizionit zbehen dhe imagjinata dërmohet.

Për t’i mbushur bateritë, është qenësore që idetë individuale—ishujt e vegjël—jo vetëm të shkojnë drejt diçkaje, por të mbesin të bashkuar. Ashtu që mbjellja e luleve në kopsht nuk vërehet e ndihet vetëm nga një rreth i ngushtë, por edhe nga të tjerët. Ashtu që njerëzit të fillojnë të dalin me kureshtje (ose me dyshim) nga bota e jashtme dhe hynë në këtë botë. Të paktën, për këtë nevojitet që sa më shumë prej nesh të imagjinojmë një kopsht dhe ta shohim atë si një tablo strategjike të përshtatur ndaj botës së përditshme, e cila, edhe nëse ndërmerr hapa të vegjël, mund të nisë alternativa të prekshme ndaj sistemit të tanishëm.



Puna emocionale



Në botën e artit bashkëkohor, ka një tension midis bërjes së artit dhe dhënies së kujdesit. tranzit.cz është një institucion feminist, që është i përkushtuar për t'i mbështetur individët me përgjegjësi të dhënies së kujdesit. Qëllimi është që të krijohet një ambient ku bërja e artit mbetet e mundur, pavarësisht realiteteve kërkuese të prindërimit. Ky eksplorim thellohet në dinamikat komplekse që shpalosen kur ambicia artistike përplasen me praktikalitetet e jetës familjare, duke hedhur dritë mbi barrat emocionale që shpesh i përcjellin këto përpjekje. Kjo mund të jetë e rëndë edhe për artistë/e, e edhe për institucione, duke vënë në pah nevojën urgjente për zgjidhje strukturore.

Imagjinoni që, si një institucion, po bashkëpunoni me një artiste që ka një fëmijë dy-vjeçar dhe një foshnjë. Artistja vjen për një rezidençë një-mujore; megjithatë, pasi fëmija i saj dy-vjeçar po qëndron në shtëpi me partnerin e saj, ajo e ndan rezidencën në periudha më të shkurtëra. Rezidenca e saj përbëhet nga një seri takimesh, për të cilat asaj i duhet një asistent i produksionit—dikush që i ndihmon t'i koordinojë oraret. Asaj po ashtu i duhet kujdes për foshnjën. Artistja zakonisht vjen në fundjava, por ajo shpesh e anulon udhëtimin në momentin e fundit. Ky është problem për ekipin mbështetës të produksionit, pasi ata/o nuk kanë mundësi ose nuk janë mjaftueshëm fleksibilë për t'i ndryshuar planet shpejt. Ju shpejt kërkon dikë tjetër, por pastaj edhe kuratori/ja edhe artisti/ja shqetësohen sepse atij personi duhet treguar gjërat prej fillimit, gjë që kërkon punë shtesë. Asistenti/ja i/e produksionit është i/e frustruar sepse ai/ajo vazhdimisht përfundon duke blerë bileta treni dhe duke i anuluar ato, duke rezervuar akomodim e duke e anuluar. I tërë projekti është më kërkues sesa që dukej në fillim. Fëmijët e artistes sëmurën vazhdimisht dhe pastaj, sëmuret edhe ajo. Ajo nuk i respekton afatet kohore, është e brengosur dhe e mërzhitur. Derisa projekti rritet, ajo ia delegon çfarëdo pune shtesë asistentit/es të produksionit—gjë që kapërcen kushtet me të cilat ai/ajo është pajtuar—sepse ajo nuk e ka kapacitetin vetë, por në të njëjtën kohë ajo vërtet e do projektin dhe dëshiron që ai të jetë në formën më të mirë të mundshme. Një ditë ajo vjen në Pragë me foshnjën e saj, e cila është e ftohur. Artistja është e merakosur mos ftohja nuk është thjesht një ftohje e zakonshme. Ajo dëshiron të shkojë në emergjencë, por natyrisht, i duhet

përcjellja e dikuj, një përkthyesi/je. Është e premtë pasdite dhe ekipi i institucionit ka plane tjera për mbrëmje. Ata veç ndihen sikur po e mbështesin artisten tërësisht përtej mundësive dhe nuk duket se artistja e shpreh mirënjohjen e saj mjaftueshëm—në fund të fundit, ajo nuk ka fjetur me muaj të tërë. Edhe unë kam plane tjera, por për dallim nga kolegët e mi, edhe unë jam nënë. E di se çka do të thotë të kesh një fëmijë të sëmurë në një vend të huaj. Shkoj me të. I kalojmë disa orë në emergjencë midis fëmijëve të sëmurë, që qajnë. Mjeku/ja i/e sjellshëm/me i thotë se është vetëm një ftohje e zakonshme. Është vonë dhe të dyja jemi të dërmuara, prandaj e dërgoj në shtëpi. E di se e kemi krijuar një shoqëri dhe ajo është falënderuese. Partneri im dhe fëmijët e mi nuk janë aq entuziastë.

Artistja është e suksesshme dhe ambicioze. Ky nuk është i vetmi projekt në të cilin po punon. I ka dy fëmijë të vegjël, të dy nën moshën tre-vjeçare, por ajo dëshiron të punojë ashtu siç punonte dikur ose aq shumë sa punonte dikur. Dhe pse jo? Është e drejtë e saj.

Jam e dërmuar nga ky bashkëpunim dhe ashtu janë edhe të tjerët. Artistja, natyrisht, është krejtësisht e rraskapitur. Dhe mendoj për faktin se kujdesi për foshnja dhe fëmijë të vegjël nxjerr punë shtesë dhe puna shtesë hidhet përreth, si patate e nxehtë. Askush nuk ka kohë, as energji. Jemi institucion feminist, duam të bashkëpunojmë me prindër me fëmijë të vegjël. Ne e organizojmë kujdesin për fëmijë, marrim me qira banesa më të mëdha për rezidentët/et, i blejmë disa bileta shtesë treni. Edhe nëse grantet nuk e kanë një kategori për këtë, bëhemi kreativë—gjithmonë e gjejmë një mënyrë. Por, kur është fjala të fëmijët e sëmurë dhe projektet kërkuese dhe ambicioze, edhe ne ngecim.

Teoritë feministe të kujdesit thonë që kujdesi duhet të shpërndahet në mënyrë të barabartë në shoqëri; megjithatë, kjo nuk është mënyra se si funksionojnë gjërat, prandaj barra bie te një person ose pak persona, të cilët mund t'i kenë ose mos t'i kenë burimet e tyre—dhe nëse s'i kanë, atëherë do ta kenë tepër të vështirë. Ata nuk mund të bëjnë art ose dështojnë keq dhe vuajnë, edhe fizikisht, edhe mendërisht.

Përvoja e artisteve dhe institucioneve, të cilët përballen me sfidat e prindërimit, vënë theksin te një hendek kritik në sistemet e mbështetjes përbrenda botës së artit. tranzit.cz përpiqet të krijojë një ambient që mundëson artin dhe kujdesin, prapëseprapë realiteti i menaxhimit të projekteve artistike midis kërkesave që lidhen me përkujdesin ndaj fëmijëve shpërfaq kufizimet e kornizave ekzistuese institucionale. Derisa të hartohen dhe zbatohen ndryshime sistemike për t'i adresuar këto pengesa, edhe artistet, edhe institucionet do të vazhdojnë të përballen me barrën e punës së panjohur, do të rrezikojnë lodhjen e tepërt dhe do të pengojnë vetë kreativitetin, të cilin ato synojnë ta ushqejnë.

Kundër diskriminimit të bazuar në aftësi të kufizuar

Anti-aftësisizmi i referohet kundërshtimit aktiv të aftësisizmit (diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar) dhe praktika-ve, qëndrimeve dhe strukturave që mirëmbajnë diskriminimin kundër personave me aftësi të kufizuara. Përfshin përkushtimin për të njohur dhe adresuar pengesat sistemike me të cilat përballen ata, avokimin për të drejtat e tyre, si dhe promovimin e gjithëpërfshirjes dhe barazisë. Anti-aftësisizmi kërkon të çrrënjosë sistemet shoqërore, kulturore dhe institucionale, që privilegjojnë personat që nuk kanë ndonjë aftësi të kufizuar, teksa marginalizojnë personat me aftësi të kufizuara.

Anti-aftësisizmi po ashtu është në një linjë me teorinë *crip*, një kornizë kritike, që sfidon supozimet normative rreth aftësisë së kufizuar dhe trupit. Kritikon pritshmëritë shoqërore të “normalitetit” dhe feston aftësinë e kufizuar si hapësirë të rëndësishë kulturore, politike dhe personale.¹ Duke përqafuar teorinë *crip*, anti-aftësisizmi kalon përtej thjesht akomodimit të aftësive të kufizuara dhe sfidon dhe ristrukturon sistemet dhe ideologjive, që përforcojnë normat e aftësisizmit. Teoria *crip* avokon për një riimagjinim të vlerave shoqërore, duke vënë theksin te ndërv-arshmëria, qasshmëria dhe festimi i trupave të ndryshëm.

La Escocesa, në bashkëpunim me artistët/et, Hac Vinent dhe Tatiana Antoni Conesa, ka zhvilluar një seri të masave konkrete të qasshmërisë dhe ka realizuar trajnime për personelin e vet, për t’u siguruar që këto masa të zbatohen. Ky proces nënkuptoi ndryshim të rëndësishëm për institucionin dhe

¹ është po ashtu relevante të theksohet ndërthurja midis aftësisë së kufizuar dhe të qenit *queer*, duke vënë në pah se si të dyja sfidojnë strukturat hegjemonike të pushtetit dhe normativitetit (Shih Robert McRuer, *Crip Theory: Cultural Signs of Queerness and Disability*). Alison Kafer zgjeron këtë në librin e saj *Feminist, Queer, Crip* duke propozuar një model politik dhe relacional të aftësisë së kufizuar që i jep përparësi ndërtimit të koalicioneve dhe drejtësisë shoqërore.

përtej, duke nxitur një ndryshim në mentalitet rreth pjesëmarrjes dhe diversitetit në art. Këto masa theksojnë rëndësinë e ngadalësimit, përdorimit të gjuhës së qasshme dhe përfshirjes së metodave të pjesëmarrjes fleksibile për aktivitetet publike. Po ashtu theksojnë nevojën për planifikim proaktiv, si për shembull, duke ofruar forma të kërkesës së qasshmërisë, duke siguruar që komunikimi të jetë i qartë dhe duke nxitur praktika të kujdesit kolektiv.

Nëse pjesëmarrja në hapësira kulturore është momentalisht privilegj, atëherë duhet të pyesim: Kush po përjashtohet dhe pse? Qasshmëria duket të jetë e mirëqenë, jo një kërkesë e veçantë. Qasshmëria e njëmendtë nuk ka të bëjë vetëm me rampa dhe interpretë të gjuhës. Të sigurosh hapësira të qasshme kërkon jo vetëm rimendimin e përmbajtjes, programimit dhe qasjeve institucionale ndaj përfshirjes, por edhe zbatimin e tyre në praktikë.


Disa konsiderata për t'i bërë aktivitetet më të qasshme:²

- Përdorni gjuhë të qartë dhe të thjeshtë në të gjitha materialet e komunikimit dhe përgjatë aktivitetit, duke iu shmangur zhargonit akademik, për të siguruar gjithëpërfshirje ndër realitete të ndryshme shoqërore.
- Shmangiuni supozimeve. Shumë masa të thjeshta të qasshmërisë shpërfillen sepse ne supozojmë se të gjithë trupat dhe nevojat i përshtaten një standardi të vetëm.
- Ofroni një formë ku pjesëmarrësit/et mund të tregojnë nevojat e tyre specifike të qasshmërisë para një vizite apo aktiviteti, ashtu që të mundësohen adaptimet e nevojshme. Nëse regjistrimi paraprak për një ngjarje nuk kërkohet, atëherë një email adresë duhet të ofrohet në materialet e komunikimit të ngjarjes, ashtu që personat të mund të kontaktojnë ekipin.
- Prezantojeni aktivitetin dhe shpjegojeni strukturën e tij, ashtu që pjesëmarrësit/et të mund të vendosin kufij personalë dhe të vendosin nivelin e përfshirjes së tyre. Një takim para ngjarjes mund të ofrohet për personat, të cilët kanë nevojë të familjarizohen me hapësirën ose t'i diskutojnë dinamikën vijuese.
- Dizajnoni aktivitetet me nivele fleksibile të pjesëmarrjes, duke ua mundësuar pjesëmarrësve/eve të përfshihen në mënyra të ndryshme. Qëndroni të hapur ndaj ndryshimit të strukturës, për të siguruar pjesëmarrje.
- Ofroni mundësi për t'iu adresuar grupit përpara se të fillojë ngjarja në rast se ndokush dëshiron të shpjegojë situatën e vet. Mbështetja duhet të ofrohet nëse ka nevojë.
- Ndiemoni në krijimin e një dinamike grupore të bazuar në respekt dhe përfshirje, duke u siguruar që t'i nderoni

² Kjo është pjesë nga praktikatat dhe puna e brendshme, të zbatuara në La Escocesa. Për më shumë informata, vizitoni ueb-faqen tonë: <https://laescocesa.org/en/La%20Escocesa/accessibility>.

të gjitha kërkesat. Ofroni mbështetje shtesë, nëse ka nevojë, me anëtarë të caktuar të ekipit, përgjegjës enkas për këtë aspekt.

- Shmangni infantilizimin, mbrojtjen e tepruar dhe mëshirën. Trajtoni të rriturit/at si të rritur/a. Për shembull, kur ndërveproni me një person të shurdhër ose dikë që përcillet nga një asistent/e personal/e, drejtojuni personit drejtpërdrejt, jo interpretit/et apo asistentit/es.
- Gjithmonë pyesni nëse nuk jeni të sigurt se si të ofroni mbështetje apo t'i akomodoni disa nevoja të caktuara.
- Qartësisht komunikoni masat e disponueshme të qasshmërisë në të gjitha materialet promovuese.
- Derisa shumica e aktiviteteve nuk janë në vetvete të qasshme, personat me diversitet funksional mund të mos supozojnë se do të ketë gjithëpërfshirje nëse kjo gjë nuk përmendet qartazi.
- Përkrahni fotografitë që i postoni në rrjetet sociale. Kjo mund të bëhet duke përdorur opsionin "alt text" ose duke përfshirë një përshkrim të shkruar në postim.
- Ofroni titra dhe/ose përshkrime me zë për videot e postuara *online* apo të shfaqura gjatë aktiviteteve.
- Përfshini paralajmërime rreth përmbajtjes për tema potencialisht shqetësuese, duke ua mundësuar personave që të bëjnë zgjedhje të informuara rreth ekspozimit të tyre.



Disa shembuj të masave të qasshmërisë për institucione dhe aktivitete:

- Rampat
- Ashensorët e mëdhenj (nëse ndërtesa është shumë-katëshe)
- Korridore të gjera, lehtësisht të shfrytëzueshme
- Banjo të qasshme
- Ulëse me mbështetëse për shpinë
- Interpretim të gjuhës së shenjave dhe hapësirë për lexim të buzëve (ulëse të rezervuara afër folësve/eve)
- Titra apo përshkrim të drejtpërdrejtë të videoeve
- Përshkrim me zë të përmbajtjes pamore
- Cilësi të mirë të zërimit në hapësirë
- Ndriçim të përshtatshëm
- Artikulim të qartë dhe me zë të lartë (pa bërtitur apo ekzagjëruar shqiptimin)
- Ofrim paraprak të teksteve për biseda apo lexime
- Marrje e strukturuar e radhës për të folur, me një moderator/e
- Përshtatja e materialeve në formate digjitale dhe lehtësisht të lexueshme
- Tekst të projektuar, me kontrast të lartë, shkronja të mëdha dhe ndarje midis paragrafëve
- Tregues taktilë ose me ngjyra të dallueshme
- Hapësira të qeta për pushim
- Shpjegim i qartë i kohëzgjatjes së ngjarjes, dinamikave dhe numrit të pritur të pjesëmarrësve/eve
- Mundësi për pjesëmarrje virtuale
- Krijoni qasje për prindërit, kujdestarët/et dhe fëmijët duke ofruar hapësira të veçanta për lojë dhe stacione për ndërrim të pelenave të bebeve.
- Tregoni qartazi nëse një aktivitet është i përshtatshëm për fëmijë.

Vetëfuqizimi

Procesi i fuqizimit duhet të jetë rreth dhënies së mbështetjes për një person apo grup, ashtu që ai person apo grup eventualisht të ketë mundësi të qëndrojë në këmbë pa mbështetjen e tjetërkujt. Kur është fjala për fushën kulturore dhe artistike, qëllimi i një procesi të fuqizimit duhet t'ia mundësojë personit apo grupit që të vazhdojë një nismë apo projekt artistik a kulturor me forcat e veta. Nëse ky proces ndodh me vetë iniciativë dhe tërësisht apo gati tërësisht pa ndihmë të tjetërkujt, atëherë fjala vetëfuqizim është e përshtatshme.



Në fillim të një mbështetjeje serioze për një proces të fuqizimit, pa marrë parasysh a iniciohet nga jashtë apo niset nga vetë fuqizuesit, ka përkushtim. Më saktë, është vullneti jo vetëm për t'i komunikuar metodat e praktikës artistike dhe kulturore, por edhe për të ndarë qasjen në burime të disponueshme dhe për t'i bartur dijet e fituara përgjatë praktikës dhe përvojës për veprim të pavarur. Nuk duhet frikësuar se mos po ofron shumë informata ose mos po ndan tepër shumë njohuri ose mos po bëhesh i panevojshëm në fund. Kur njerëzit mësojnë një shkathtësi dhe janë të aftë të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre, atëherë është logjike që ata përfundimisht nuk do të kenë nevojë për "instrukturët".

Kur ndodhi pushtimi rus në shkallë të plotë i Ukrainës, në shkurt të vitit 2022, bashkë me tranzit.at në Vjenë dhe e Künstler*innenhaus Büchsenhausen në Innsbruck, si dhe Ministrinë Federale të Austrisë për Art, Kulturë, Shërbim Civil dhe Sport, < rotor > në Graz nisëm Zyren Ukrainë — Strehim për artistët ukrainas.

Nga ai moment, një numër artistësh dhe punonjësish kulturorë nga disiplina të ndryshme artistike gjetën një vend të sigurt për të qëndruar në Austri. Ekipi në Zyra Ukrainë në Graz ofroi mbështetje për personat e zhvendosur, kryesisht në zonën e Graz dhe provincën e Styria, duke u ndihmuar atyre që të gjejnë akomodim, të merren me çështjet administrative dhe të ballafaqohen me jetën e përditshme. Qëllimi afatgjatë ishte dhe është që t'i lidhim artistët e rinj që po jetojnë në qytet dhe provincë me artin dhe skenën kulturore lokale dhe ta bëjmë më të lehtë për ta që të kenë qasje në të gjitha shërbimet dhe programet e ofruara nga institucionet publike dhe organizatat e pavarura.

Të ashtuquajturat shtëpi të hapura u organizuan gati çdo katërbëdhjetë ditë, duke u mbajtur me ndërrime midis < rotor > dhe institucioneve tjera të ndryshme nga fusha e artit dhe kulturës, çështjeve shoqërore, shëndetit, punës e kështu me radhë. Ekspertët/et nga fushat respektive raportuan për aktivitetet e tyre dhe i ndanë metodat e punës me organizatat dhe institucionet austriake. Për shembull, pjesëmarrësit/et në shtëpitë e hapura patën mundësi ta familjarizojnë veten me logjikën e mjedisit institucional, strukturës së mundësive për fonde dhe proceset që duhen ndërmarrë për t'i themeluar vetë institucionet e veta ose për ta nisur aktivitetin e tyre të vetëpunësimit artistik në Austri. Shumica e aktiviteteve kishin për qëllim që ta bënin më të lehtë për anëtarët e rinj të skenës kulturore të qytetit të Graz dhe provincës Styria, që t'i nisin ditët e tyre si artistë dhe punonjës kulturorë.

Në kohën e botimit, pushtimi në shkallë të lartë në Ukrainë ka bërë tri vjet dhe Zyra Ukrainë ka ekzistuar për aq kohë. Luftës nuk po i duket fundi, por një pikëpamje e re po shpërfaqet për Zyren Ukrainë Graz. Tash e disa muaj, komuniteti artistik ukrainas në Graz ka qenë duke krijuar vendin e vet për prezantim dhe produksion artistik, të quajtur ZIEGEL. Dhe Zyra Ukrainë Graz mund ta konsiderojë veten me fat për faktin që është mbështetur logjistikisht dhe përcjellur nga një projekt qysh prej fillimit, projekt ky që bazohet në vetëorganizimin e kolegëve ukrainasë përbrenda mjedisit kulturor dhe artistik në Austri. Dhe mbase, projekti ZIEGEL do të zhvillohet në një drejtim, në të cilin aktivitetet e Zyra Ukrainë Graz mund të lulëzojnë. E ardhmja do të tregojë nëse ky vizion është përmbushur.

(Ç)mësimi



Çmësimi është aftësia për të menduar dhe vepruar ndryshe, për t'i lënë pas vetes rutinat dhe mënyrat e dijes, të cilat janë të fiksuara dhe shpeshherë na pengojnë nga përparimi ose përshtatja në situata të reja. Nuk do të thotë harrim, por heqje dorë nga përvoja dhe dija e fituar më parë. Pasi të mësuarit është zakonisht një proces i gjatë dhe i ndërlikuar, ashtu është edhe të çmësuarit. Siguria e së njohurës zëvendësohet me pasigurinë dhe rrezikun e të panjohurës, por mundësia e përvijës së re—mundësia e ndryshimit dhe transformimit—fuqizon këtë proces sfidues.

OFF-Biennale është një kolektiv civil i vetëorganizuar, i themeluar në vitin 2014-15 si përgjigje ndaj situatës së krizës. Centralizimi i institucioneve artistike shtetërore hungareze, ekspozimi i tyre politik dhe largësia e tyre nga profesionaliteti e bëri të pamundur për shumë prej nesh që të vazhdonim të imagjinonim punën tonë përbrenda kësaj kornize. Prandaj, filluam diçka radikalisht ndryshe, pavarësisht faktit që nuk dinim se nga t'ia nisim, si të organizoheshim, si të bëheshim komunitet i përgjegjshëm dhe i vetëidentifikuar—komunitet që do të bënte bashkë dhe shumësonte zërat kritikë, mënyra të reja të të punuarit së bashku dhe hapësira të reja për t'i bërë gjërat ndryshe. E ngitnim biçikletën derisa e rregullonim, thonim.

Deri në atë kohë, disa prej nesh kishim përvojë të konsiderueshme profesionale, pasi kishim realizuar projekte, por themeli më i fuqishëm i dijes dhe përvojës sonë vinte nga puna jonë institucionale—vite të tëra të kaluara nëpër muze, galeri, universitete. Pavarësisht vështirësive të tyre, tensioneve të brendshme dhe pasigurisë financiare në rritje, shumica e institucioneve ofronin një bazë të fuqishme të dijes dhe një parashikueshmëri—një bazë prej së cilës mund ta shtynim

veten përpara. Mënyra e funksionimit të institucioneve ishte mjaft e fiksuar, me disa rregulla të vendosura paraprakisht dhe fleksibiliteti e ndryshimi ishin të kufizuara përbrenda kornizave të padukshme. Bëmë shumë përshtatje dhe mësuam ta bënim atë sepse, prej një moshe të hershme, përshtatja në institucione ishte kusht themelor për të mbijetuar.


Kur klima politike në vend u bë vërejtshëm e vështirë, kur përfaqësimi i vlerave, të cilat i përqaftuam u bënë institucionalisht të pamundura, kur shtypja sistematike u bë më e gjerë, provuam të imagjinojmë një realitet tjetër. Dhe jo vetëm ta imagjinojmë atë, por ta jetojmë dhe ta bartim atë. Të shtireshim sikur të ishte e mundur të ndërtonim një bienale ndërkombëtare vetë, pa infrastrukturë dhe burime të sigurta. U shtirëm dhe kështu, e ndërtuam atë së bashku. Funksionoi, por për të funksionuar—siç e kuptuam në proces, nganjëherë më vonë—na u desh të hiqnim dorë nga dija dhe përvoja, t'i vërenim dhe t'i ndalonim shprehjet që presupozonin ekzistencën e një kornize sipër nesh, që na jepte një ndjesi të sigurisë dhe një ndjesi të të qenit të lidhur sepse tash po i bënim kornizat vetë, shpesh të reja.

Kemi mësuar shumë nga puna jonë institucionale; kemi qenë efektivë, të disiplinuar dhe rigorozë me veten, por tash nuk kemi shkuar në atë drejtim. E kemi braktisur, midis tjerash, mbështetjen shtetërore dhe komunale, që dikur merrej si e mirëqenë dhe po fillojmë të punojmë në një strukturë të re të financimit, të bazuar në bashkëpunim ndërkombëtar dhe (më pak) në sistemin vendor privat të mbështetjes, që është në zhvillim e sipër, por është ende i dobët.


Na është dashur të mësojmë nga fillimi se si të punojmë si komunitet në bërje, të zhvillojmë mënyra të vendimmarrjes, një sistem të brishtë dhe të ndjeshëm të bashkëpunimit në të cilin vazhdojmë pa dominim, në shumë mënyra, herë me ndërrim udhe, e herë në udhë pa krye, por megjithatë drejt një caku. Në kontekstin e një kolektivi të grave si OFF-Biennale Budapest, të mësuarit gjithashtu nënkupton ekzaminimin kritik dhe refuzimin e normave dhe praktikave që mirëmbajnë strukturat partiarkale dhe njohjen dhe pranimin e faktit se gratë kanë përvoja të ndryshme jetësore. Të funksionuarit komunitar presupozon dëgjimin dhe kuptimin e rrëfimeve të njëri-tjetrit dhe pranimin e dallimeve në identitetet. Kjo fije e vogël prej shumë anëve bëhet bashkë kur mësojmë kolektivisht. Baraspesha e të mësuarit nuk është negative; dija nuk humbet, por ndërron, përkthehet, transformohet.

Ky proces po ndodh tash e një dekadë. Nuk mund të themi se kemi arritur diku, por as nuk mund të themi se nuk kemi arritur diku. Edhe pse ne vetë nuk do ta kishim menduar, jo vetëm që u desh që shumë aspekte të dijës institucionale të kalonin nëpër një proces të çmësimit, por kështu ka ndodhur edhe me shumë mënyra tjera të punës, të cilat i kemi zhvilluar vetë. Edhe pas shumë vitesh, ende po mësojmë sërish e sërish se si të bashkëpunojmë, si të komunikojmë, si të mos përshtatemi. Dhe gjithë këtë e bëjmë, herë duke u dëmtuar, herë duke u gëzuar. Dhe prapë, ka ende shumë për të çmësuar.

Pa financim afatgjatë, një bazë të qëndrueshme organizative dhe siguri ligjore, zotimet personale janë burimet e organizatave jo-qeveritare, pa të cilat ndryshimi nuk do të ndodhë, por të cilat nuk janë domosdoshmërisht të mjaftueshme për të arritur ndryshim. Kur mendojmë për një kontekst të sigurt, ne nuk mendojmë më për rrjetet institucionale, por për aleancat e bazuara në punë profesionale, solidaritet dhe shoqëri, të cilat i kemi ndërtuar përgjatë dekadës së fundit. Dhe ky është një kontekst, i cili, duhet shtuar, është vazhdimisht i kërcënuar pikërisht sepse i vendosim një barrë të rëndë mbi supë. Ne caktojmë pritshmëri për veten, të cilat çojnë në vetë-eksplloatim, lodhje dhe dërmim, gjë që na i konsumon burimet personale dhe komunitare. Mbase kjo është një tjetër shprehje që do të na duhet ta çmësojmë, ashtu që të vazhdojmë ta mirëmbajmë veten.



Lehtëso dhe de-eskalo



Në një ambient në të cilin një grup njerëzish bashkëpunojnë, konflikti është ndodhi natyrore. Qoftë në kolektive të punës, diskutime në komunitet apo ambiente edukimi, mendimet, personalitetet apo këndvështrimet e ndryshme çojnë në tension. Megjithatë, krejt kjo nuk ka nevojë të jetë e dëmshme. Këtu vjen në pyetje roli i lehtësuesit/es. Qëllimi i një lehtësuesi/je është që të sigurohet që të gjithë pjesëmarrësit/et të ndihen se zëri po u dëgjohet, teksa njëkohësisht e drejton grupin drejt qëllimeve, aspiratave dhe shtigjeve të përbashkëta.

Mospajtimet janë pjesë natyrale e dinamikave grupore. Lehtësuesit/et mund të parandalojnë konfliktet duke mbështetur një kulturë të të dëgjuarit aktiv, duke inkurajuar pjesëmarrësit/et që të kuptojnë pikëpamjet e tjetrit përpara se të kërcejnë në përfundime. Kur ndodhin keqkuptimet, një lehtësues/e mund t'i qartësojë ose t'i përmbledhë qëndrimet, ashtu që të parandalojë keqkuptimet dhe të mundësojë respekt të përbashkët. Duke identifikuar një pikë të përbashkët dhe duke artikuluar qartazi fushat e mospajtimit, lehtësuesit/et mund të ndihmojnë pjesëmarrësit/et të mbesin të përqendruar në synimin e përbashkët në vend të dallimeve. Në raste kur emocionet janë të forta, një lehtësues/e mund të de-eskalojë tensionin thjesht duke e njohur ekzistencën e konfliktit. Duke i dhënë emër çështjes, pjesëmarrësit/et kanë mundësi të shkojnë një hap mbrapa dhe të krijojnë një pamje më të gjerë të çështjes. Lehtësuesit/et po ashtu mund të sugjerojnë pushime, ashtu

që njerëzit të kenë kohë të qetësohen dhe reflektojnë. Nëse është e nevojshme, ata/o mund të organizojnë biseda individuale për të kuptuar më mirë pikëpamjet përplasëse, duke kultivuar një ndjesi të të qenit të dëgjuar dhe vlerësuar. Mbi të gjitha, megjithatë, siç na kanë mësuar Elja Plíhal dhe Zuzana Kašparová, gjatë një punëtorie rreth procesit të lehtësimit, thelbi i rolit të lehtësuesit/et qëndron në besimin se sjellja e njerit është simptomë e dinamikës së të gjithëve. Roli i lehtësuesit/es është që të zbërthejë dhe të gjejë udhën përbrenda kësaj dinamike. Lehtësimi për të cilin kemi mësuar, ofron një alternativë ndaj përjashtimit, largimit apo dënimit të një individi, pa e përfshirë tërë komunitetin. Për këtë, ai luan një rol kaq të rëndësishëm në drejtësinë restauruese dhe transformative.

Në kampin veror në kontekstin e Biennale Matter of Art 2024 morën pjesë fëmijë nga klasa të ndryshme sociale: fëmijë nga Praga 7 (një pjesë shumë e gjentrifikuar e kryeqytetit), fëmijë të refugjatëve ukrainas dhe fëmijë nga lagjja e “Přivoz” në Ostrava (një pjesë shoqërisht problematike e qytetit). Pashmangshëm, kishte konflikte, të cilat vetëm sa pasqyronin tensionet e gjera shoqërore. Konfliktet që ndodhën midis fëmijëve u zgjidhën përmes teknikave të lehtësimit dhe qasjes restauruese të këshilluesve të kampit.


Palëve në konflikt iu dha hapësirë që të tregonin anën e tyre të rrëfimit, pastaj ata që u prekën nga konflikti patën mundësi ta shpjegonin ndikimin që konflikti pati në ta dhe, në fund, të dy palët mund të punonin bashkë për të gjetur mënyra se si do të mund të funksiononin dhe komunikonin me njëri-tjetrin. E gjithë kjo ndodhi nën udhëzimin e lehtësuesve/eve të rritur/a. Falë tyre, jo vetëm që një vajzë nga një prapavijë e klasës së mesme të lartë dhe një vajzë nga një prapavijë shumë e marginalizuar, të cilat e kishin vështirë ta kuptonin njëra-tjetrën, ishin të afta të bashkëjetonin dhe punonin në një grup, por edhe nuk u dëmtua i gjithë grupi për shkak të konfliktit të tyre.

Mënyra se si ndërmjetësuesit/et tanë/këshilluesit e kampit veror iu qasën konfliktit na u duk shumë frymëzuese në një kohë kur ndihemi sikur mbijetesa e organizatave kulturore varet nga bashkëpunimi dhe pajtimi me një grup të gjerë njerëzish, nismash dhe organizatash. Gjetja e një pike të përbashkët dhe navigimi i dallimeve të perceptuara, na duket e rëndësishme jo vetëm në sferën kulturore, por edhe në shoqëri në përgjithësi. Në shoqëritë tona—për arsye si gjentifikimi, sistemet arsimore që riprodhojnë padrejtësinë

shoqërore ose shpërndarja e pabarabartë e burimeve në qytete të mëdha në krahasim me rajonet tjera të vendit—ka pak e më pak hapësira ku njerëzit nga prapavijat e ndryshme klasore mund të takohen dhe të ndërveprojnë. Përmes kampit, ne krijuam një hapësirë që fëmijët nga prapavijat e ndryshme kulturore dhe klasore të takohen dhe ndërveprojnë. Pas kampit, kur e pyeta një vajzë nga Praga për mendimin e saj, ajo i quajti fëmijët nga Ostrava “të çuditshëm” dhe “të pazakonshëm”. Mund të duket se ky ishte dështim i projektit, një përforsim i stereotipeve shoqërore, racizmit e kështu me radhë. Megjithatë, më kujtohet takimi dhe bashkëjetesa në shkollë fillore me fëmijë që më dukeshin “ndryshe” ose “të pazakonshëm”—fëmijë prej prapavijave shumë ndryshe nga e imja.

I kam kuptuar sjelljen dhe qëndrimet e tyre tek vite më vonë. Por a përballen me diçka të panjohur fëmijët e së sotmes, të cilët shpërngulen në hapësira homogjene për kah klasa? A nuk është kjo ndjenjë e parehatisë e rëndësishme që hapësira jonë publike të jetë demokratike, heterogjene dhe gjithëpërfshirëse? A nuk duhet të mësojmë të jetojmë me njerëz, të cilët na duken “të pazakonshëm” A është ky roli i kulturës sot kur institucionet tjera dështojnë ta përmbushin atë rol?

Shumica globale



Termi “minoritet” shpesh nënkupton nënshtrim ose më pak rëndësi, duke përforcuar stigmat apo stereotipet, thellësisht të rrënjosura në trashëgimi koloniale. Për dallim prej kësaj, “shumica globale” njeh faktin që njerëzit me prejardhje afrikane, aziatike, latino-amerikane dhe indigjene e përbëjnë shumicën e popullsisë së botës. Ky ndërrim në terminologji sfidon pikëpamjet eurocentrike, që i pozicionojnë këto grupe si minoritete, pavarësisht rëndësisë numerike dhe kulturore të tyre. Po ashtu, shpreh se si kornizat koloniale, historikisht, kanë i fshirë dhe abuzuar epistemologjitë jo-Perëndimore, duke përforcuar shtypjen sistematike.

Termi fton për aplikimin e një pikëpamjeje dekoloniale me qëllim që të çrrënjosen strukturat koloniale, të mishëruara në institucionet kulturore dhe fton që të rimendohet se si ndërmjetësimi artistik mund të shpërbejë si mjet për rezistencë dhe riparim.

Termi u lind gjatë një ngjarjeje në La Escocesa, si pjesë e Trenza. Dizajnuar nga kolektivi Lumbre, përbrenda kornizës së Art Space Unlimited, Trenza (gërsheta) është një program ndërmjetësimi, qëllimi i të cilit është të realizojë një thirrje të hapur që La Escocesa të bëhet shtëpi për komunitetet, të cilat momentalisht nuk banojnë në të.

Trenza përqendrohet në njerëz që migruan nga Jugu Global, të cilët janë të përfshirë në prodhimin dhe praktikën e artit dhe kulturës dhe të cilët, për shkak të pabarazisë strukturore, nuk janë ende pjesë e rrethit të artit bashkëkohor të qytetit. Ky program ndërmjetësimi është i strukturuar përmes zhvillimit të mjeteve dhe takimeve, qoftë të hapura për publikun apo të mbyllura për grupe specifike.

Migrimi është një proces i çrrënjësjes, jo vetëm territoriale dhe emocionale, por edhe profesionale. Më të mbërritur në “territorin pritës”, mbijetesa ekonomike dhe burokracitë

administrative, që lidhen me dokumentacionin e migrimit, marrin përparësi. Zakonisht merr kohë të ndërtohen rrjete emocionale dhe mbështetëse, që është arsye pse karrierat profesionale, të nisura në vendin e origjinës, mbesin të pezuluara. Puna në fushën e artit ka tendencë të jetë veçanërisht e ndërlikuar pasi secili vend i ka dinamikat dhe gjuhën e vet që, pas arritjes, kërkojnë procese përkthimi, të cilat mund të jenë mjaft frustruese.

Ky projekt ndërmjetësimi nisët prej këtij realiteti, duke pozicionuar artistët migrantë jashtë kategorive të artistëve në bërje, të rinj apo në mes të karrierës së tyre. Migrimi ripërcakton trajktoreset artistike, duke i matur karrierat jo me standardet konvencionale, por përmes përvojës së përbashkët të kalimit prej Jugut Global në një territor evropian.

Një moment i rëndësishëm në këtë projekt ishte kur Lumbrë ndau pikëpamjen rreth termit “minoritet” dhe tha se fjala e bartte peshën e kolonializmit; koncepti i Shumicës Globale, në anën tjetër, e çonte fokusin drejt një pikëpamjeje kritike.

Adoptimi i termit Shumicë Globale në hapësira kulturore dhe artistike nuk ka të bëjë vetëm me gjuhën; ka të bëjë me ndërrimin e mënyrës se si angazhohemi me komunitete dhe me çrrënjosjen e trashëgimive koloniale në ndërmjetësimin artistik. Në Trenza, kjo qasje nënkuptonte vënien në pikëpyetje të praktikave institucionale, të cilat shpeshherë e shfrytëzojnë diversitetin, në vend se të nxisin bashkëkrijim të njëmendtë, duke shpërfaqur se si shumë politika kulturore janë bashkëndihmëse të kornizave koloniale të pushtetit.

Duke vënë në qendër pikëpamje të Shumicës Globale, projektet si Trenza sfidojnë strukturat që vazhdojnë të marginalizojnë grupe të caktuara, duke ofruar njëkohësisht modele për punë më të drejtë dhe më kuptimplote kulturore. Një qasje dekoloniale jo vetëm që e ndryshon terminologjinë, por edhe e sfidon vështirimin kolonial, duke krijuar vend për narrativa të reja dhe praktika transformuese, që shkojnë nga gjithëpërfshirja simbolike drejt rishpërndarjes së pushtetit dhe burimeve.

About the Organizations

tranzit.cz

Nisma për art bashkëkohor tranzit.cz, u themelua në vitin 2002, në Pragë, Çeki. Nisma organizon ekspozita, rezidenca artistike dhe kuratoriale dhe programe diskursive, që të gjitha me qëllimin që të kontribuojë në zhvillimin e qasshëm dhe pjesëmarrës të kulturës kritike. Prej vitit 2020, tranzit.cz ka organizuar Biennale Matter of Art dhe që prej vitit 2023, dy herë në vit organizon një festival të artit performativ. Në vitin 2017, tranzit.cz nisi krijimin e institucioneve Code of Feminist (Art). tranzit.cz po ashtu ka botuar përkthime në gjuhën çeke të teksteve nga fushat e teorisë kritike, filozofisë, teorisë së artit, feminizmit dhe prozës (nga autorë/e si McKenzie Wark, Sophia Giovannitti, Sophie Lewis, Audre Lorde, Frantz Fanon, Bruno Latour, Marcel Duchamp dhe të tjerë/a).

Si pjesë e projektit Art Space Unlimited, tranzit.cz organizoi një seri të punëtorive të ndërmjetësimit dhe një kamp veror për fëmijët e gruposhës 9-14 vjeç. Këto ngjarje ishin pjesë e Biennale Matter of Art 2024. Projekti i ndërmjetësimit, i quajtur “The Great Land of Small” (Toka e madhe e të vegjëlve) synonte t’i ndihmonte fëmijët prej prapavijave të ndryshme shoqërore që të gjejnë një mënyrë të veçantë për të menduar rreth artit dhe ekspozitave, si dhe të fitojnë vetëbesimin që t’i shprehin mendimet e veta. Fëmijët eksperimentuan me mënyra të ndryshme të përcimit të mendimeve, ëndrrave dhe ideve të tyre—nga incizimet me zë te gazetatat deri te kontributi në vizatime. Pjesëmarrësit u udhëzuan nga artistët/et dhe edukatorët/et, Eva Koťátková, Bára Šimková, Mary C, Magda Stojowska dhe Tadeáš Polák. Projekti rezultoi me botimin e gazetës së fëmijëve “This is not baloney” (Kjo nuk është palidhje), që përbëhej nga intervistat, raportet, vizatimet dhe fotografitë e krijuara nga fëmijët.

< rotor >

Themeluar në vitin 1999, < rotor > Qendra për Art Bashkëkohor ndodhet në Graz, Austri. Programi i institucionit bazohet në artet pamore dhe përqendrohet në veprat artistike,

që në mënyrë të hapur trajtojnë çështjet shoqërore, politike, ekologjike dhe ekonomike të së tashmes. Qendra e pavarur e artit është e strukturuar si shoqatë dhe e ndjek një mision edukativ. Si rrjedhojë, ndërjmetësimi të një publik më i gjerë ka rëndësi të madhe. Promovimi i bashkëpunimit dhe veprimit të rrjetëzuar është element themelor i filozofizë së < rotor >.

Kjo ka të bëjë me përpjekjet për rrjetëzim përbrenda fushës së artit, por edhe me përfshirjen e njerëzve dhe organizatave nga prapavijat tjera. Kërkimi për metoda bindëse të bashkëpunimit dhe mundësive të pjesëmarrjes në procese artistike është një tjetër temë me rëndësi. Një aspekt i rëndësishëm është përfshirja e njerëzve, të cilët në të kaluarën kanë pasur pak qasje në art bashkëkohor. Për < rotor > hapësira publike është mjedis i rëndësishëm për ta jetësuar artin. Akti i lënies së hapësirës së artit përdoret për të promovuar dhe rishikuar praktikat artistike përpara një publiku të gjerë, për t'i negociuar publikisht temat dhe për t'i vënë njerëzit në kontakt me artin, në mënyrë aktive.

Si pjesë e Art Space Unlimited, < rotor > ka shpeshtuar bashkëpunimin midis artistëve dhe punonjësve kulturorë dhe disa grupeve të synuara të audiencës. Projektet e zbatuara synonin në veçanti gratë, fëmijët, rininë dhe njerëzit me të kaluar emigruese. Në tri ekspozitat e njëpasnjëshme, disa nga veprat e prezantuara u prodhuan në një mënyrë pjesëmarrëse, si dhe u ofruan punëtori dhe programe të edukimit artistik.

Ekspozita “Wild Spots” (Pika të egra) fliste për lidhjen midis njerëzve që jetojnë në qytet dhe “natyrës së egër”; për “Sediment”, artistët/et dhe kuratorët/et turke-kurde u përqendruan te lumenjtë e rrezikuar; dhe “Mostly mined out” (Kryesisht të larguar me mina) pasqyroi migrimin e shtyrë nga lufta të ukrainasve.

La Escocesa

La Escocesa është organizatë dhe rezidencë e arteve pamore bashkëkohore, e menaxhuar kolektivisht përmes shoqatës së artistëve Associació d'Idees EMA. Ne përqendrohemi në mbështetjen e organizatave dhe agentëve kulturorë, duke u ofruar hapësira pune dhe burime për t'i zhvilluar projektet e tyre. Ne ofrojmë studio dhe punëtori për rreth tridhjetë artistë rezidentë, bashkë me një program falas të ngjarjeve, thirrjeve të hapura dhe trajnimeve. Si hapësirë e komunitetit artistik, ne nuk përqendrohemi vetëm në prodhimin dhe krijimin e veprave, por edhe në krijimin e përbashkët të dijes, rrjeteve të kujdesit dhe mënyrave të reja të ndërtimit dhe funksionimit të institucioneve kulturore. Natyra kolektive e funksionimit të

qendrës mundëson pjesëmarrjen aktive të artistëve/eve, duke krijuar një strukturë kolektive horizontale, përmes së cilës menaxhohet qendra. Si institucion feminist, vlerat tona burojnë nga pozita ndërthurëse, emancipuese, bashkëpunuese dhe gjithpërfshirëse, që avokon për qëndrueshmëri, eksperimentim, bashkëpunim dhe zhvillim të projekteve komunitare artistike. Ne i kuptojmë vlerat jo vetëm si një varg qëndrimesh, por si zotime që duhet të jetësohen përmes një procesi kolektiv të mësimi dhe reflektimit të vazhdueshëm.

Në kuadër të Art Space Unlimited, La Escocesa zhvilloi Trena, një program ndërmjetësimi, të dizajnuar nga kolektivi Lumbre. Qëllimi i Trena është që të krijojë një thirrje të hapur që La Escocesa të bëhet shtëpi për komunitetet, të cilat momentalisht nuk e frekuentojnë atë. Trena përqendrohet në migrantët nga Jugu Global, të cilët janë të përfshirë në prodhim dhe praktikë të artit dhe kulturës dhe të cilët, për shkak të pabarazive strukturore, nuk janë ende pjesë e qarqeve të artit bashkëkohor në qytet. Propozimi organizohet në tri linja: Zjarri, Toka dhe Aleancat. Këto linja, të ndara, por të ndërv-arura, synojnë të jenë të gërshetuara përbrenda dhe përreth komunitetit që e frekuenton La Escocesa me qëllim që të krijohen aleanca.

OFF-Biennale

OFF-Biennale Budapest është një nismë komunitare, që ofron platformë për art bashkëkohor pamor përparimtar dhe kritik. Përgjatë 10 viteve të fundit, OFF-Biennale është bërë ngjarja më e madhe e artit të pavarur bashkëkohor në Hungari. Ka për synim të fuqizojë skenën lokale të artit të pavarur dhe të kontribuojë në diskursin publik në çështje sociale, politike dhe mjedisore, me qëllimin që të promovojë një kulturë të demokracisë përmes artit. Në një klimë politike jo mbështetëse ndaj vetëorganizimit dhe aktivizmit qytetar dhe kulturor, OFF ka mbetur një prej organizatave të pakta në Budapest, që ende punon në mënyrë aktive në krijimin e një mjedisi për liri të shprehjes, duke përforcuar pavarësinë dhe duke imagjinuar një model për një institucion transparent dhe autonom të artit, që fiton qëndrueshmëri nga rrjetet e tij të shumta e të gjera vendore dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të OFF-Biennale 2025 ne ftuam Recetas Urbanas—një kolektiv ndërkombëtar i arkitektëve dhe artistëve—për një bashkëpunim në Budapest. Bazuar në metodologjinë e tyre, që promovon arkitektutren e angazhuar në aspektin shoqëror përmes përfshirjes së komunitetit dhe dizajnit të përbashkët, ne do të realizojmë një projekt të arkitekturës komunitare me organizata lokale dhe komunitete në lagjen

shumëkulturore të Distriktit VIII, te sheshi “Kálvária”. Struktura e planifikuar jo vetëm që do të bashkëdizajnohet dhe ndërtohet me pjesëmarrësit, por ata po ashtu do të përcaktojnë funksionin e saj, bazuar në vizionet dhe nevojat e tyre, duke i kthyer kështu mungesat në mundësi. Ndërtimi, që po ashtu paraqet temën qendrore të OFF 2025, është më shumë sesa thjesht një strukturë fizike—është një proces. Prej dhjetorit 2024, punëtori dhe ngjarje të ndryshme bashkëpunuese kanë bërë bashkë komunitete të ndryshme që jetojnë, punojnë dhe e përdorin lagjen: komunitetet lokale rome, grupet civile të distriktit, migrantët dhe refugjatët, si dhe fëmijët dhe të rriturit nga kontekste të pafavorizuara.

Shtatëmbëdhjetë (17)

Shtatëmbëdhjetë (17) është organizatë kulturore në Prishtinë, Kosovë, i përkushtuar që të nxisë ndryshim shoqëror përmes nismave artistike dhe edukative. I themeluar në vitin 2018, Shtatëmbëdhjetë ka si vizion një shoqëri ku të gjithë qytetarët marrin pjesë lirshëm dhe në mënyrë kuptimplotë në jetën publike përmes kulturës, edukimit dhe aktivizmit. Puna e fondacionit përqendrohet në aktivizëm kulturor, hapësirën publike, politikbërje, avokim, qëndrueshmëri mjedisore, barazi gjinore dhe të drejta të njeriut. Përmes funksionimit në hapësirat e veta kyçe—Galeria 17 dhe Rezidenca 17— Shtatëmbëdhjetë shërben si vend për edukim, aktivizëm dhe eksplorim të guximshëm artistik.

Përbrenda Art Space Unlimited dhe përbrenda përkushtimit të vet ndaj ndërmjetësimit kulturor, Shtatëmbëdhjetë (17) ka zhvilluar ekspozita dhe ngjarje komunitare si “Queer Ecology”, një eskpozitë që shtjellonte çështjet mjedisore përmes teorisë *queer*, një punëtori për poezi rreth narrativave *queer* dhe një sesion pune me letër të ricikluar si medium për shprehje artistike. Duke krijuar hapësira për mësim kolektiv dhe angazhim kritik, programi fuqizon lidhjet midis artit, aktivizmit dhe komuniteteve lokale.

Nuk mund të themi që kemi arritur diku, por as nuk mund të themi që nuk kemi arritur diku Fjalorth i termave të përbashkimit

Ky libër po ashtu u botua në gjuhët angleze, çeke, gjermane, hungareze dhe spanjolle. Versionet në të gjitha gjuhët janë të qasshme si EPUB dhe PDF dhe shkarkohen në www.emotional-labor.eu



Redaktor
Iwo Maciak

Menaxher i projektit
Max Dvořák

Tekstet
Anton Lederer, Ajete Kërqeli,
Tereza Stejskalová, Iwo Maciak,
Clara Piazuolo, Alba Colomo,
Rita Kálmán, Nikolett Erőss,
Eszter Lázár

Lektorimi
Brian D. Vondrak

Dizajni dhe ilustrimi
Day Shift Office

Dizajni i brendshëm
FK Grotesk Neue, Montagu Slab

© 2025 Biennale Matter of Art,
La Escocesa, OFF-Biennale, < rotor >,
tranzit.cz, Shtatëmbëdhjetë (17)

Kjo punë është e licensuar nën
Creative Commons (CC) Attribution-
NonCommercial-ShareAlike 4.0
International. Mund të citoni,
shpërndani dhe ta zhvilloni tutje
këtë material, për aq kohë sa i jepni
meritat e duhura krijuesve, vetëm për
qëllime jo-komerciale.

ISBN 978-80-87295-78-8

tranzit.cz
Dittrichova 337/13
120 00 Prague
CZ
cz.tranzit.org
www.matterof.art

Botuar nga by.tranzit.cz përbrenda
projektit Art Space Unlimited.
tranzit është nismë në fushën e artit
bashkëkohor. Partneri kryesor i saj
është ERSTE Foundation.



Co-funded by
the European Union

tranzit.cz

Ve věci umění
Matter of Art



MINISTERSTVO
KULTURY



ERSTE
Stiftung

Ky libër u botua me mbështetjen
e Ministrisë së Kulturës së Republikës
Çeke, si pjesë e projektit Art Space
Unlimited, bashkëfinancuar
nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet
dhe mendimet e shprehura janë
vetëm të autorit/es(ëve/eve) dhe jo
domosdoshmërisht paraqesin ato
të Bashkimit Evropian dhe të EACEA.
Bashkimi Evropian apo EACEA nuk
mund të mbahen përgjegjës për to.